



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË OST MBI PROJEKTIN "EFIÇENCA
ENERGJETIKE - PROGRAMI PËR SEKTORIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË"**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË
NË OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
TIRANË**

Për projektin "Eficenca energjetike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"

Tiranë më, dhjetor 2021

Nr.	Përshkrimi	Faqe
I.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3-11
1.	Përshkrim i shkurtës i Projektit të Auditimit	3-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimet	3-5
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	5-6
II.	HYRJA	7-9
a.	Objektivat dhe qëllimi	7-7
b.	Identifikimi i çështjes	8-8
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
d.	Përgjegjësitë e audituesve	8-8
e.	Kriteret e vlerësimit	8-9
f.	Standardet e auditimit	9-9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10-42
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	10-10
2.	Përshkrimin i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	10-42
2.A	Marrëveshjet e financimit të Projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve. .	10-19
2.B	Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në Marrëveshjet me huadhënësit.	19-21
2.C	Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.	21-27
2.D	Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësit, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra dhe shërbime deri në lidhjen e kontratës.	27-36
2.E	Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe shërbimeve	36-42
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	42-49

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i projektit të Auditimit

Projekti "Efiçenca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", financohet nga Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (Kf) në formën e Huas, me një kosto totale të parashikuar në vlerën 40 milionë Euro. Huaja rregullohet nga ligji nr. 88/2015 datë 30.07.2015, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane Kf për Projektin "Efiçenca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike".

Qëllimi i këtij Projekti është rritja e efiçencës së transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet shtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të nënstacioneve elektrike dhe linjave të transmetimit të tensionit të lartë, për të minimizuar humbjet teknike dhe siguruar vazhdimësinë pa ndërprerje të transmetimit të energjisë elektrike.

Bazuar në ligjin nr. 88/2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim" kosto totale e parashikuar është në vlerën 40 milionë Euro.

Nga auditimi ka rezultuar se, nuk janë realizuar indikatorët për secilin komponent, vonesa të theksuara në ecurinë e projektit dhe kjo ka çuar në nivelin e ulët të disbursimeve si edhe në mos përfundimin në afatin e parashikuar të tij me 3 vjet vonesë, shoqëruar me kosto shtesë.

Deri në përfundim të auditimit është disbursuar 19% e kredisë.

Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.

Projekti ishte parashikuar të përfundojë në dhjetor të vitit 2018, por ende nuk ka filluar faza e implementimit, pra projekti është me vonesë prej 3 vite deri në periudhën e auditimit.

Miratimi për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2022, nuk do të jetë i mjaftueshëm pasi nisur nga ecuria dhe problematikat në faza të ndryshme të projektit ku ende nuk kanë filluar punimet.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
1	Janë realizuar amendime të shumta të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015, shoqëruar me zgjatje të afatit të përfundimit të projektit dhe kosto shtesë.	Pika A, Faqe 10-19	E lartë	Drejtoria e projekteve të huaja, në bashkëpunim me njësinë e zbatimit të projekteve të bëjnë parashikime të sakta për kostot e financimit dhe afatet e realizimit të projektit mbi bazën e studimit të fizibilitetit apo rishikimit të tij në Këshillin Teknik, dhe pasi ti miratojnë në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, të pasqyrohen në marrëveshjet e huas.

2	<p>- Për realizimin e punimeve janë ndryshuar 2 komponentë Komponenti I ka rritur koston e financimit me 141,726 euro, mbi vlerën e huas.</p> <p>Si pasojë e ndryshimit të konfigurimit të ÷komponentit I÷ të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015, OST do të paguaj një kosto shtese për financimin e projektit me 141,726 euro mbi vlerën e huas ose 2,431,963 euro më shumë se vlera e parashikuar ne raportin final të konsulentit.</p> <p>-Komponenti II, ka ndryshuar hyrjen në nënstacione nga linja ajrore në atë kabllore e cila reflektohet me rritjen e koston së shërbimit të konsulentit me 326,645 Euro. Amendimi i kontratës së konsulentit ka rritur koston e shërbimit të konsulentit me 326,645 Euro, mbi vlerën e kontratës fillestare, ku vlera totale e kontratës së konsulentit pas amendimit është 2,458,615 euro, ose 208,615 euro më shumë se vlera e planifikuar në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015.</p>	Pika A, faqe 10-19	E Lartë	<p>Administratori i shoqërisë të analizojë efektin negativ të vlerës prej 326,645 euro si pasojë e ndryshimit të konfigurimit të komponentit II, dhe i reflektuar në amendimin e kontratës së konsulentit të projektit.</p> <p>-Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me këshillin teknik dhe konsulentin, të dakordësojnë termat referencës për kontraktorët e zbatimit të projektit, mbi bazën e studimit të fizibilitetit, dhe nëse ky i fundit ka nevojë për ndryshime ato të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të pasqyrohen në amendimin e marrëveshjes para se të përfshihen në dokumentet e tenderit për kontraktorët e zbatimit të projektit</p> <p>- Drejtoria e Projekteve të Huaja, gjatë fazës së hartimit të termave të referencës për tenderin e shërbimit të konsulentit së projekteve duhet të bashkëpunoj me Këshillin Teknik të OST, për të analizuar dhe reflektuar ndryshime të mundshme, të komponentëve të projektit të përcaktuara në marrëveshjen e huas.</p>
3	<p>-Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.</p> <p>-Shuma e disbursuar deri më datë 23.12.2021 është 7,561,247 Euro, ku shuma e pa disbursuar është në nivelin e 32,438,752 Euro, ose 19% e shumës së kredisë, komisionet e paguara janë në shumën prej 541,171 Euro dhe interesa të paguar në shumën 230,037 Euro pagesa interesi.</p> <p>-Projekti është parashikuar të përfundojë në dhjetor të vitit 2018 dhe ende nuk ka filluar faza e implementimit, pra projekti është me 3 vjet vonesë deri në periudhën e auditimit.</p>	Pika C, faqe 21-27	E Lartë	<p>OST dhe NJZP të marrin masa që në të ardhmen, për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare, me qëllim minimizimin e kostove shtesë dhe krijimin e një opinionit pozitiv ndaj huadhënësit në përdorimin e financimit.</p>
4	<p>Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST Nr. 388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në</p>	Pika C, faqe 21-27	E Lartë	<p>Drejtoria e menaxhimit të projekteve, në të ardhmen të marrë masat e duhura që ecuria e disbursimeve për projektet e financuara</p>

<p>Korrik të vitit 2022. Banka Kf , me letrën e datës 26.08.2019, ka pranuar në parim shtyrjen e afatit të disbursimit, por thekson pagesën e një vlerë kompensimi si pasojë e shtyrjes së afatit të disbursimit, ku Huadhënësi pranon se kjo vlerë është bazuar në kushtet e tregut të kapitalit që ka preluar në kushtet e llogaritjes së kësaj vlere, duke theksuar se asnjë kosto shtesë nuk përfshihet në vlerën prej 861,206 Euro. Kf në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë me OST pranon të mbulojë 50% të shumës dhe pjesa tjetër të mbulohet nga OST, dhe për këtë nuk ka asnjë llogaritje ose mënyra e llogaritjes nga Banka Kf për caktimin e vlerës prej 377,519 Euro. Huamarrësi (OST) ka rënë dakord për të paguar detyrimin e paraqitur nga Banka Kf dhe ka likuiduar vlerën 377,779 Euro (377,519 Euro + 260 Euro komision banke), e cila përbën efekt financiar negativ për OST. Për këtë vlerë nuk është paraqitur nga Kf asnjë dokument për mënyrën e llogaritjes si edhe nga Drejtoria Ekonomike e OST, veprimet në kontabilitet janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.8, datë 17.02.2003 për evidentimin regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajë.</p>			<p>nga Kf apo donatorë të tjerë të huaj, të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë që mbart zgjatja në kohë e afatit të disbursimit si dhe me shmangien e procedurave të tej zgjatura që nevojiten për miratimin e ndryshimeve financiare në marrëveshjet e ratifikuara.</p>
<p>Pagesat e kryera sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2021 janë në vlerën 110,227 Euro. më tepër nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin. Po kështu, deri në fund të vitit 2021, nga OST është paguar vlera 541,171.⁰⁶ Euro, e cila deri në përfundim të projektit ishte parashikuar në vlerën 430,945 Euro, pra zgjatja e afatit të disbursimeve shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit.</p>	<p>Pika C, faqe 21-2</p>	<p>5</p>	<p>Administratori i OST Sh.A dhe NJZP të marrin masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për shumën 110,227 Euro, si kosto shtesë e paguar për tarifën e angazhimit, që në të ardhmen për projektet me financime të huaja, të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas.</p>

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së projektit "Eficienca energjetike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", prej fillimit të tij në vitin 2015 deri më 23.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar¹.

¹ Opinioni i kualifikuar shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë janë materiale, por jo të përhapura

Baza për opinionin e kualifikuar.

Nga auditimi, kemi arritur në konkluzionin se për realizimin e projektit janë bërë ndryshime të Marrëveshjes së Huas, miratuar me ligjin nr. 88/2015, me disa amendime për riskedulimin e pagesave dhe zgjatjen e afatit të disbursimit; ndryshime të komponentëve; nuk janë realizuar indikatorët për secilin komponent; vonesa të theksuara në ecurinë e projektit dhe kjo ka çuar në nivelin e ulët të disbursimeve, si edhe në mos përfundimin në afatin e parashikuar të tij me 3 vjet vonesë, të cilat janë shoqëruar me rritje të kostos së projektit. Shuma e disbursuar deri në 23.12.2021 **është në nivelin 19%** e shumës së huas, disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta. Në lidhje me procedurat e prokurimit, kemi konstatuar mangësi dhe shkelje të Udhëzuesve të Bankës Kf , ku procedura e tenderit të zhvilluar me objekt òShërbimi i konsulencës është kryer me zgjatje të afatit kohor prej 1 viti, si pasojë e një parregullsie të ndodhur gjatë procedurës së vlerësimit të ofertës teknike, mbi hapjen e zarfit të ofertës financiare para afatit kohor të përcaktuar. Kemi konstatuar rritje të kostove financiare, të cilat kanë rezultuar nga ndryshimi i komponentëve të marrëveshjes së huas, komisione angazhimi mbi planin si rezultat i mosrealizimit të afateve dhe objektivave të projektit dhe penalizime nga Banka Kf , etj, ***në shumën 956,377 Euro dhe 38,973 Euro penalitete të pambajtura.***

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë.

Është detyrimi i menaxherëve të njësisë, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar: Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000 dhe 4100*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne, si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 òDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 30 òKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSHö, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 281/1, datë 30.04.2020, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 04.05.2020 deri në datën 19.06.2020, në subjektin Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) për *Projektin "Efiçenca energjetike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"* për periudhën nga fillimi i Projektit viti 2015 deri më 19.06.2020, u krye auditim përputhshmërie nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- M. B., Përgjegjës Grupi
- A. L., Auditues
- E. S., Auditues

Në vijim të auditimit me Programin e Auditimit nr. 254/1, datë 30.04.2020, me Autorizimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 281/4, datë 14.12.2021 për auditim dhe plotësim evidenca auditimiö, u ushtruar auditim nga data 14.12.2021 deri më datë 23.12.2021, për verifikimin dhe plotësimin me dokumentacion dhe evidenca auditimi lidhur me saktësimin e nivelit të realizimit të projektit deri më 23.12.2021, nga Grupi i Auditimit me këtë përbërje:

- S. B., Përgjegjës Grupi
- M. K., Kryeauditues
- A. L., Auditues

1. Objekti i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) auditori, Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me efektivitetin e përdorimit të fondeve të Kredisë si dhe zbatimin e përcaktimeve në Marrëveshjen e kredisë të miratuar me ligjin 88/2015 për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për Projektin *öEfiçenca energjetike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrikeö*, financiar në shumën 40,000,000 euro nga banka gjermane Kf . Pjesë e rëndësishme e auditimit kanë qenë rregullshmëria e realizimit të objektivave të Projektit, niveli dhe ecuria e disbursimeve, procedurave të prokurimit konform rregullave dhe udhëzimeve të miratuara nga Banka Kf , korrektësia e zbatimit të kontratave të punëve civile dhe konsulencës si edhe ndryshimet ligjore të tyre. Nga grupi i auditimit u audituan realizimi i objektivave të përcaktuara në Marrëveshje për komponentët e Projektit si dhe disbursimet referuar realizimit të tyre. Realizimi i raporteve të përcaktuara në Marrëveshje dhe dorëzimi në kohë i tyre në Kf raportimet mbi disbursimet dhe shpenzimet. Hartimi i pasqyrave financiare dhe dorëzimi i tyre në Ministri të Financave dhe Ekonomisë kanë qenë pjesë e auditimit në përputhje me drejtimit e auditimit të përcaktuara në programin e miratuar. Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes edhe fakti i marrjes në dorëzim i raporteve/ shërbimeve të kryera nga konsulenti pasi kontratat për punime civile ende nuk kanë filluar deri në fazën e përfundimit të Auditimit.

2. Qëllimi i auditimit

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

Me auditimin e përputhshmërisë, përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara, zbatimin e kontratave, zbatimin e kërkesave të Marrëveshjes në periudhën nën auditim. Auditimi do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Marrëveshjet e financimit të Projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të Projektit në krahasim me ato të përcaktuara në Marrëveshjet me huadhënësit.

Mbi menaxhimin financiar të Projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në Marrëveshje me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.

Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.

Mbi administrimin e veprave të përfunduara si edhe probleme të tjera që mund të rezultojnë gjatë procesit të auditimit.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim

Drejtori i Projektit: Drejtori i Projektit duhet të garantoj implementimin optimal të Projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatorëve të huaj. Ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementimin e Projektit të huaj që në fazat e para të financimit e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.

Drejton dhe ndjek procedurat e Marrëveshjeve të Kredisë me donatorët që bashkë-financojnë Projektin: ndjek procesin e tenderimit në bashkëpunim me asistencën e konsulencës së huaj në të gjitha fazat. Merr pjesë në negociimin e kontratave që parashikohen të nënshkruhen, ndjek administrimin e kontratave, zbatimin në kohë, me efektivitet dhe cilësi të Projektit, zbatimin e Marrëveshjes së Huas sipas kushteve përkatëse. Monitoron ecurinë e Projektit, ndjek zbatimin në kohë të problemeve financiare, siguron kontroll financiar dhe siguron cilësinë e Projektit, etj.

Shefi i Sektorit të Projekteve: Ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e Marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse, etj.

Specialisti financiar: Ndjek procedurat në lidhje me çështjet financiare duke u bazuar në Marrëveshjen e Huas duke respektuar afatet dhe kushtet e përcaktuara. Ndjek regjistrimet financiare dhe mirëmban gjithë dokumentacionin me karakter financiar që ka lidhje me projektet e huaja.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë mbi përputhshmërinë, në bazë të auditimit tonë. Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e P/Raportit të auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim, që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi ka vlerësuar nivelin e kontrollit të brendshëm që nuk është në nivelin e duhur, në mënyrë që të programojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për kushtet e këtij institucioni publik.

6. Kriteret e vlerësimit

Raporti i Auditimit është kryer mbi bazën e legjislacionit kryesor si:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;

Ligji 88/2015 òPër ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (Kf) për Projektin òEfiçenca energjetike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”

VKM nr. 116, datë 24.02.1997 òPër kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisëò;

VKM nr. 452, datë 01.07.1998 òPër disa masa në përmirësimin e punës për financimin e Projekteve që financohen nga donatorë të huajò;

Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 òPër evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e Projekteve dhe Marrëveshjeve me donatorët e huajò;

Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003 òPër përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësisve të menaxhimit/zbatimit të Projekteve dhe Marrëveshjeve me donatorë të huajò;

Udhëzuesit e prokurimit të Huadhënësit për prokurimet e fondeve për mallra, punime dhe shërbime dhe akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit

Bazuar në standardet ISAI 100 òParimet themelore të auditimit në sektorin publikò dhe ISAI 400 òParimet themelore të auditimit të përputhshmërisëò si edhe në Kodin Etik të KLSH.

8. Metodatat e auditimit

Auditimi është kryer me zgjedhje për prokurimet dhe pagesat e situacioneve dhe në total për amendamentet referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, ku në Memon e planifikimit dhe fondeve në dispozicion janë përcaktuar materialiteti dhe risku si dhe transaksionet për auditim ku periudha e zgjedhjes së auditimit të transaksioneve është përcaktuar sipas gjykimit të audituesit por duke përfshirë në kohë të gjithë periudhën e zbatimit të Projektit deri në momentin e auditimit.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 òDokumentimi i Auditimitò.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Operatori i Sistemit të Transmetimit, është institucion publik në vartësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE) dhe ku parimet e përgjithshme, fusha e veprimit si dhe mënyra e funksionimit të tij janë të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, Statuti i Shoqërisë, etj. Ky institucion funksionon mbi bazën e këtij ligji dhe akteve të dala në funksion të tij.

Rëndësia e auditimit të Projektit “*Efiçenca energjetike, programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike*” realizuar në OST, që do të kontribuojë në rritjen e efiçencës së transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet shtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të nënstacioneve elektrike dhe linjave të transmetimit të tensionit të lartë, për të minimizuar humbjet teknike dhe për siguruar vazhdimësinë pa ndërprerje të transmetimit të energjisë elektrike. Grupi i auditimit ka planifikuar auditimin e drejtimeve të auditimit në masë të konsiderueshme të transaksioneve, duke përfshirë të gjithë numrin e tyre dhe të raporteve të rezultuara gjatë periudhës së implementimit të Projektit. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

Në përfundim të procesit të auditimit për secilin drejtim të auditimit, rezultoi për sa më poshtë vijon:

A. Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit

Programi për efiçencën e energjisë në sektorin e transmetimit, financohet nga Banka Gjermane (Kf në formën e huas në shumën 40 milion euro.

Auditimi është kryer mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e zbatimit të projektit (PIU).

Më poshtë, në mënyrë të përmbledhur paraqiten hapat e ndjekura deri në ratifikimin e marrëveshjes së huas me Kf në shumën 40 milion euro, për projektin "Eficiencia energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike":

1. Këshilli Mbikëqyrës² i OST, më datë 19.12.2014 ka autorizuar administratorin e OST për nënshkrimin³ e marrëveshjes së huas. Administratori i shoqërisë OST SHA nëpërmjet shkresës nr.7895 Prot. datë 22.12.2014, ka kërkuar nga ministri i MZHETS miratimin dhe autorizimet ligjore përkatëse për nënshkrimin e marrëveshjes së huas dhe marrëveshjes së veçantë për programin e efiçencës së energjisë në sektorin e transmetimit, midis Kf dhe OST SHA.

2. Asambleja⁴ e Përgjithshme e Aksionerëve e përfaqësuar nga ministri i MZHETS, ka miratuar dhe ka dhënë autorizimet përkatëse për nënshkrimin e marrëveshjes së huas dhe marrëveshjes së veçantë për òProgramin për efiçencën e energjisë në sektorin e transmetimitò midis Kf dhe OST SH.A.

² Bazuar në nenin 23 të Statutit të OST

³ Vendimi nr. 31 date 19.12.2014 òPër miratimin dhe autorizimin përkatës për marrëveshjen e huas dhe marrëveshjen e projektit òProgrami për efiçencën e Energjisë në sektorin e transmetimitò midis KfW dhe OST SHA,

⁴ Vendimin nr. 8752/1 Prot, datë 23.12.2014

3. Qeveria shqiptare me vendimin nr.476, datë 03.06.2015, ka miratuar në parim marrëveshjen për bashkëpunimin financiar 2011, me Republikën Federale Gjermane për projektin "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike".

4. Marrëveshja e huas për financimin e programit të eficientës së energjisë elektrike në sistemin e transmetimit për shumën prej 40 milion euro u nënshkruar midis Kf dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) në rolin e huamarrësit, në datë 30.06.2015.

5. Marrëveshja e huas, ka hyrë në fuqi më datë 22.08.2015, sipas përcaktimit të nenit 2 të ligjit nr.88/2015 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike" i miratuar më datën 23.07.2015 dhe dekretuar me ligjin nr. 9200, datë 30.07.2015 nga Presidenti i RSH.

6. Marrëveshja e garancisë u ratifikua me ligjin 84/2015 për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Kf Frankfurt am mainö, në lidhje me marrëveshjen e huas, në shumën 40 milionë euro, ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sha (OST), dhe Kf , në mbështetje të projektit "Eficienca energjetike - programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"

Qëllimi⁵ i përdorimit të huas:

Huamarrësi (OST) do të përdor huan ekskluzivisht për të financuar zbatimin e infrastrukturës të transmetimit për Linjën e Transmetimit Tiranë - Rrashbull ("Komponent I"), për Linjën unazore të Transmetimit Tirane ("Komponent II") si dhe për shërbimet e konsulencës brenda dy komponentëve I dhe II.

Pas ratifikimit në Parlamentin e Shqipërisë së marrëveshjes, dhe garantimit të saj nga Qeveria Shqiptare, Kf⁶ në bazë të nenit 4.1 të marrëveshjes, përcaktoj normën e interesit 1.7% p.a. (1.7% për vit).

Në nenin 3.1, të marrëveshjes së huas tarifa e angazhimit, parashikohet pagesa 0.25% e shumës së padisbursuar të huas, e cila paguhet përkatësisht në datat 30 Qershor dhe 30 Dhjetor. Në nenin 3.2 të marrëveshjes së huas është përcaktuar tarifa e menaxhimit, ku huamarrësi do të paguajë Kf -së një tarifë menaxhimi, një herë të shumës totale të pakthyeshme prej 1,0% të shumës të huas deklaruar në nenin 1.1⁷ të marrëveshjes së huas.

Huaja e përfitur nga kjo marrëveshje është në kuadër të "Programit për Eficientën e Energjisë në sektorin të transmetimit" që do të kontribuojë në rritjen e eficientës së transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

OST në rolin e huamarrësit do të financojë ngritjen e infrastrukturës së transmetimit për Linjën e Transmetimit Tiranë 2-Rrashbull (Komponent I), dhe për Linjën e Transmetimit - Tirana Ring (Komponent II), si dhe për shërbimet e konsulencës për të dy komponentët.

Në marrëveshjen e huas pika 1.2 përcaktohet që, detajet e projektit, procedura e disbursimit dhe zbatimit të projektit, huamarrësi dhe Kf -ja do të paraqiten në marrëveshje të veçantë. Marrëveshja e veçantë është miratuar më datën 02.07.2015, ku janë detajuar, nenet 1.2 (detajet e projektit); 2.4 (procedura e disbursimit) dhe 10.1 (zbatimi i projektit) të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015

Në marrëveshjen e veçantë është parashikuar se aktivitetet që do të do të financohen nga huaja, për këtë projekt janë:

- a) Shërbimi i konsulencës në kuadër të dy komponentëve I dhe II;
- b) Në kuadër të komponentit I:
 - Ndërtimi i një linje të re 220 kV me qark të dyfishtë ndërmjet Tiranës dhe Rrashbullit dhe
 - fuqizimi dhe zgjerimi i nënstacioneve Rrashbull dhe Tiranë 2;

⁵ Neni 1.2 i marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015

⁶ Konfirmimi i KfW i datës 28.08.2015

⁷ KfW i jep Huamarrësit një hua që nuk kalon një total prej 40,000,000 EUR

c) Në kuadër të komponentit II:

- Zgjerimi i rrjetit të transmetimit 110 kV në zonën e Tiranës (ndërtimi/fuqizimi i linjave të transmetimit Tiranë 1 - Traktori- Tiranë 3; Tiranë 3 - Selitë dhe Tiranë 3 - Farkë) dhe
- Lidhja në linjën e transmetimit 400 kV Tiranë-Elbasan përmes ndërtimit të nënstacionit të ri Tirana 3.

Tabela nr.1 Kostot dhe plani i financimit të projektit (në Euro)

Aktivitetet	2015	2016	2017	2018	Total
Component I Tirana - Rashbull		3,350,000	6,700,000	6,700,000	16,750,000
Component II Tirana Ring		9,033,333	9,033,333	5,433,334	23,500,000
Consulting Service	562,500	562,500	562,500	562,500	2,250,000
Contingencies	100,000	800,000	800,000	800,000	2,500,000
Total	662,500	13,745,833	17,095,833	13,495,834	45,000,000

Burimi: Aneksi 3 i marrëveshjes së veçantë datë 02.07.2015

Në marrëveshjen e veçantë është parashikuar që kostoja e përgjithshme e projektit është afërsisht 45 milion euro. Shuma e përgjithshme e huas është 40 milion euro. Huamarrësi (OST) do të kontribuojë me 5 milionë euro sipas neneve 1,3 dhe 9 të marrëveshjes së huas (tatimet, tarifat doganore, detyrimet publike). Në tabelën 1. pasqyrohen kostot dhe plani i financimit përgjatë viteve 2015-2018.

Titulli i Gjetjes:

Njësia e zbatimit të projektit nuk ka specialist inxhinier të fushës së zbatimit të projektit “Efiçenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”

Situata 1:

Nga auditimi konstatohet se ka pasur ndryshime të vazhdueshme të personelit të njësisë së zbatimit të projektit, dhe mungesë të specialistëve në fushën e inxhinierisë në stafin e PIU, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen dhe implementimin e projekteve të huaja.

Sipas përcaktimeve të *seksionit 2* të marrëveshjes së veçantë (zbatimi i projektit), struktura përgjegjëse për zbatimin e projektit në OST është njësia e përhershme e zbatimit të projektit (PIU).

Njësia e zbatimit të projektit përbehet nga:

Shefi i sektorit të njësisë së zbatimit të projektit (PIU);

2(dy) jurist;

2(dy) ekonomist;

1(një) sekretar/arkivist.

Pra ky sektor ka në përbërjen e vet 6 (gjashtë) specialistë. Njësia e zbatimit të projektit (PIU) është në varësi të Drejtorisë së projekteve të huaja.

Në rregulloren e OST ne lidhje me detyrat⁸ funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në aparatën qendror të OST ShA është përcaktuar, që:

Drejtorja e projekteve të huaja garanton implementimin optimal të projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatoreve të huaj. Ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementim e projektit të huaj që në fazat e para të financimit, e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.

Spektori i projekteve PIU ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo

⁸ Miratuar me nr. 2404/5 Prot. date 24.07.2019.

	konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij, dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse.
Kriteri:	Marrëveshja e huas për projektin "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike" dhe rregullorja e shoqërisë.
Shkaku:	Ndryshime të shpeshta të strukturës së njësisë së zbatimit të projektit.
Ndikimi/Efekti:	Mbi monitorimin dhe zbatimin e projektit, nga ana e kontraktorëve për projektin <i>ëEficienca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike</i>
Rëndësia:	E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3985/3 Prot., datë 28.07.2020 ëMbi Projekt Raportin e Auditimit nga z. S...D..., me detyrë Drejtor i Kabinetit të Administratorit të OST, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

...Përpara miratimit të strukturës në korrik 2019, sektori i projekteve PIU ka pasur në përbërjen e tij staf inxhinierik, të cilët për periudha të caktuara kohe kanë qenë të pa angazhuar për shkak të hapësirave midis projekteve. Ky numër inxhinieresh të cilët nuk kishin efikasitet në punën e tyre të përditshme (jo për faj të tyre), përbente një fenomen të papranueshëm për OST.

Për këtë arsye, u vendos që ky staf bashkë me te tjerët, dhe të alokoheshin në drejtorinë e planifikimit zhvillimit të rrjetit të transmetimit/sektori i menaxhimit të projekteve.

Rekomandimi i grupi të KLSH, që duhet të këtë staf inxhinierik për ndjekjen e zbatimit të projekteve të huaja është i zbatueshëm sepse në strukturën e re është parashikuar që specialistet në sektorin e menaxhimit të projekteve do të emërohen si administrator kontrate me detyra dhe funksione shtesë të përcaktuara tashmë, në funksion të një projekti me fonde të huaja apo me fonde të OST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Së pari, në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se gjatë fazës së hartimit të projekt raportit nuk është paraqitur observacion mbi akt konstatimin e audituesve shtetëror të KLSH, mbi konstatimin e mungesës së stafit inxhinierik në fushën e zbatimit të projektit në sektorin e zbatimit të projekteve të huaja pranë OST.

Rekomandimi i lënë në projekt raport nga audituesit shtetëror të KLSH për përfshirjen në strukturën e PIU-t edhe staf inxhinierik, kishte të bënte me rritjen e performancës së sektorit të menaxhimit të projekteve të huaja, i cili ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij, dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Ndryshimet e marrëveshjes, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve

Amendimi i marrëveshjes së huas për riskedulimin e pagesave

Administratori i OST me shkresën nr. 2728 Prot. datë 13.04.2018, ka paraqitur kërkesën pranë Kf për rishikimin e termave të huas, mbi rishqyrtimin e afatit të disbursimeve dhe skedulit të pagesave të huas. Këshilli Mbikëqyrës⁹ dhe Asambleja¹⁰ e Përgjithshme, miratoi ndryshimet e kërkuara nga administratori i OST për ndryshimet e marrëveshjes së huas.

⁹ Vendimi nr.38 datë 27.06.2018

Amendimi i marrëveshjes së huas për zgjatjen e afatit të disbursimit të huas.

Administratori i OST ka kërkuar përsëri shtyrjen e afatit të disbursimit deri më datë 30.12.2022 nga Kf¹¹. Kf zgjatjen e afatit të disbursimit të huas, e kishte kushtëzuar, me detyrimin e OST për kryerjen e pagesës në shumën 861,206 euro si tarifë kompensimi.

Pas përfundimit të negociatave të OST me Kf, tarifa e kompensimit është përcaktuar në vlerën 377,519 euro, e cila përbën kosto shtesë për këtë projekt dhe është paguar nga buxheti i OST.

Amendimi i marrëveshjes së datës 27.09.2019, ka shtyrë, afatin e disbursimit deri më datë 31.12.2022.

Këshillit Mbikëqyrës ka miratuar me vendim nr. 80, datë 16.09.2019, amendimin e marrëveshjes për shtyrjen e afatit të disbursimit. Vlera e penalitetit të vendosur për shkak të shtyrjes së afatit të disbursimit nuk është argumentuar nga ana e Kf, por edhe administratori dhe këshilli mbikëqyrës i OST, nuk ka kërkuar shpjegime mbi mënyrën e llogaritjes së penalitetit për OST në vlerë 861,206 euro nga Kf.

Amendimi i aneksit 6 i marrëveshjes së veçantë.

Marrëveshja e veçantë është amenduar pas miratimit dhe dhënies së autorizimit për miratimin e saj nga Këshilli mbikëqyrës me vendim nr. 12 datë 14.04.2017 dhe asambleja e përgjithshme e aksionerëve me nr. 4160/1, datë 5.05.2017. Në këtë amendim është ndryshuar aneksi 6 (gjashtë) ku janë përfshirë komponentët e kryesor të projektit dhe kërkesat për procedurën e tenderit për konsulencën dhe kontraktorët.

Titulli i Gjetjes:	Amendimi i marrëveshjes së huas
Situata 2:	Amendimi i marrëveshjes së huas së datës 29.06.2018, pasqyron ndryshimin e skedulit ¹² të pagesave të kredisë duke mos ndryshuar afatin e disbursimit ¹³ të përcaktuar në nenin 2.2 ¹⁴ të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015 të kërkuar prej OST. Amendimi i marrëveshjes së huas, më datë 27.09.2019, shtyu afatin e disbursimit deri më datë 31.12.2022. Këshillit Mbikëqyrës miratoi me vendim nr. 80 datë 16.09.2019, amendimin e marrëveshjes për shtyrjen e afatit të disbursimit.
Kriteri:	Marrëveshja e huas për projektin "Eficiencia energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike".
Shkaku:	Mos respektimi i marrëveshjes së huas.
Ndikimi/Efekt:	Mos realizimi i objektivave të përcaktuara në marrëveshjen e huas për shkak të mos respektimit të afateve kohore të realizimit të këtij projekti.
Rëndësia:	E lartë
Titulli i Gjetjes:	Ndryshimi i komponentit II të marrëveshjes së huas.
Situata 3:	Këshilli Teknik, në mbledhjen e datës 14.11.2016, shqyrtoi dy opsione të paraqitura nga konsulenti i projektit "F...", të paraqitura më poshtë: <i>Opsioni i parë:</i> Lidhet me kërkesën e konsulentit për ndryshimin e linjave të hyrjes në nënstacionet 110KV nga linja ajrore (OHL ¹⁵) në linja kablore për komponentin II të përcaktuar në marrëveshjen e huas, me

¹⁰ vendim Nr. 94 datë 29.06.2018,

¹¹ Me shkresën nr. 3888 Prot., date 11.06.2019

¹² Fillojnë në datën 30.06.2021, dhe afati të fundit kanë datën 30.12.2029.

¹³ Në këtë fazë KF nuk pranoi të shtyhej afati i disbursimit përtej datës 30.06.2019

¹⁴ Afati maksimal i disbursimit është data 30.06.2019

¹⁵ OHL-Overhead Line

objekt: ÷Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV: Tirane 1-Traktori -Tirana 3, Tirane 3-Selite dhe Tirana 3-Farkëo

Opsioni i dytë:

Paraqet kërkesën e konsulentit, mbi nevojën e realizimit të një studimi të plotë për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110 kV të rajonit të Tiranës (ku përfshinë të gjitha nënstacionet dhe linjat në këtë projekt).

Anëtarët e Këshillit Teknik¹⁶ shprehen dakordësi me kërkesën e konsulentit për miratimin e opsionit të dytë, duke dal me vendimin: *Të negociohen të dy opsionet dhe ti hapet rrugë konsulentit për realizimin e një studimi të koordinimit të mbrojtjes rele për një pjesë sa më të gjerë të sistemit të transmetimit (opsioni i dytë).*

Pra, anëtarët e Këshillit Teknik miratuan kërkesën e konsulentit për kryerjen e një studimi të plotë, për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110 KV të rajonit të Tiranës, e cila sipas tyre, do ti shërbejë qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në afat gjatë.

Pavarësisht vendimit të Këshillit Teknik nr. 7096 Prot., datë 14.11.2016, OST bëri amendimin e kontratës së konsulentit me nr. 1585/1 Prot. me date 24.03.2017 duke pasqyruar vetëm opsionin e parë te propozuar nga konsulenti. Ndërkohë në marrëveshjen e huas komponenti II ÷Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV: Tirane 1óTraktorióTirane 3, Tirane 3óSelite dhe Tirane 3óFarkeo është parashikuar që, hyrjet në këto nënstacione të jenë linja ajrore. Në dokumentet e tenderit për termat e referencës (ToR) të përgatitura nga Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me OST dhe të dakordësuara nga Kf , për komponentin II, hyrja në nënstacionet 110 kV është përcaktuar me linjë ajrore.

Amendimi i kontratës së konsulentit rriti kostot e shërbimit të konsulencës me 326,645 euro mbi vlerën e kontratës fillestare, ku vlera totale e kontratës së konsulentit pas amendimit është 2,458,615 euro ose 208,615 euro më shumë se vlera e planifikuar në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015.

Kriteri:

Marrëveshja e huas, statuti i shoqërisë, rregullorja e këshillit teknik, dhe detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në aparatën qendror të OST.

Shkaku:

Mos respektimi i marrëveshjes së huas.

Ndikimi/Efekti:

Amendimi i kontratës së konsulentit ka rritur kostot e shërbimit të konsulencës me 326,645 euro nga vlera fillestare¹⁷ e kontratës, duke e çuar atë në vlerën totale 2,458,615 euro, ose 208,615 euro më shumë se vlera e planifikuar në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015.

Rëndësia:

E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3985/4 Prot. datë 28.07.2020 ÷Mbi Projekt Raportin e Auditimito nga znj. A...V..., me detyre shefe e sektorit te njësisë se zbatimit te projektit pranë OST, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

¹⁶ Proces verbali me nr. 7096 Prot. datë 14.11.2016

¹⁷ Kontrata me konsulentin F... është nënshkruar 05.09.2016 për vlerën 2,131,970 euro

Pretendimi i subjektit:

...në procedurën e prokurimit per përzgjedhjen e konsulences, termat e referencës janë hartuar nga Angjenti i tenderit ne baze te udhëzuesit përkatës te KfW dhe dokumentave stadarde te bankës. Ato janë përcjell OST nga Agjenti i tenderit dhe pasi kane marre miratimin (No-Objection) te bankës, janë perfshire ne dokumentat e tenderit. Gjithashtu sqarojmë se studimi i fizibilitetit nuk përfshin/përmend realizimin e procedurës se prokurimit te konsulences, kështu qe nuk ka relevance me termat e referencës.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Rëndësia e bashkëpunimit të drejtorisë së projekteve të huaja me këshillin teknik është shumë e rëndësishme gjatë fazës së hartimit dhe miratimit te termave te referencës për përzgjedhjen e konsulentit të projektit. Pretendimi i subjektit për këtë pikë duket i pa kuptim dhe për më tepër qe e zhvlerëson rendësin e rezultateve të studimit te fisibilitetit, aq të nevojshëm gjatë fazës së fillimit te projektit, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Titulli i Gjetjes:

Situata 4:

Ndryshimi i komponentit I të marrëveshjes së huas.

Në marrëveshjen e huas¹⁸, objekti për òkomponentin Iò është: òNdërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tirana2 - Rrashbull dhe unaza 110 kV e Tiranësò.

Sipas përcaktimit të marrëveshjes, ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe duhet të realizohet, me bazamente, shtylla të tensionit të lartë, izolatorë dhe përcjellës me tension 220 kV. Këshilli Teknik në mbledhjen¹⁹ e datës 14.11.2016 ka marrë në shqyrtim studimin e shkurtuar për opsionet e ndërtimit të linjës Tirana2-Rrashbull, hartuar nga konsulenti F...²⁰.

Në përfundim këshilli teknik ka marrë vendim që ndërtimi i linjës Tirana2 - Rrashbull me dy qarqe, të realizohet me bazamente dhe shtylla për tensionin 400 KV dhe me përcjellës me tension 200 kV. Këshilli Teknik në mbledhjen²¹ e datës 12.11.2018 ka marrë në shqyrtim vlerësimin e 2 (dy) konfigurimeve për ndërtimin e linjës 220 kV me dy qarqe Tirana2-Rrashbull, të cilat paraqiten si më poshtë:

Konfigurimi A²², parashikon që ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me: “Bazament dhe shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, por me izolator dhe përcjellës për tension 220 kV”.

Pra ndryshe nga parashikimi i komponentit I, në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, òKonfigurimi Aò ndryshon shtyllat e tensionit të lartë nga 220 kV në 400kV.

Konfigurimi B, parashikon që ndërtimi i linjës Tirana2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me:

“Shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, ku njëri qark të ketë izolator dhe përcjellës për tension 400 KV, kurse qarku tjetër të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220 kV”.

Pra ndryshe nga parashikimi i òkomponentit Iò, në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, me òKonfigurimin Bò, do të kemi shtylla të tensionit 400 kV, ku në njërin qark do të ketë izolator dhe

¹⁸ Miratuar më date 30.06.2015

¹⁹ Proces verbal me nr. 7096 Prot. Date 14.11.2016

²⁰ Short System Study for Tirana- Rrashbull Transmission Line, Rev. 07.11.2016

²¹ Proces verbal me nr. 7786 Prot date 12.11.2018

²² Miratimi për òKonfigurimin Aò është marrë me vendim të Këshillit Teknik të datës 14.11.2016

përcjellës për tension 400 kV dhe në qarkun tjetër do të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220 kV.

Pavarësisht zgjedhjes së konfigurimit A apo B, linja Tirana2 - Rrashbull, të dyja qarqet, do të operoj vetëm me tension 220 kV edhe për një kohë të gjatë sipas anëtareve të këshillit teknik

Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 12.11.2018 nuk ka marrë vendim për asnjë nga opsionet e propozuara, pasi nga 10 (dhjetë) anëtarë pjesëmarrës në mbledhje, 5 (pesë) prej tyre pranuan konfigurimin A dhe 5 (pesë) të tjerët konfigurimin B. Në këto kushte është rënë dakord nga anëtarët e këshillit teknik, që ti paraqesin opinionet e tyre administratorit dhe në varësi të situatës financiare të kompanisë, të vendoset për variantin që do të implementohet.

Në mbledhjen e këshillit teknik të datës 23.11.2018, janë risjellë përsëri për rivlerësim të dyja konfigurimet për projektin ò Linja 220 kV me dy qarqe Tirana2-Rashbull dhe unaza 110 kV e Tiranësò. Në përfundim Këshilli Teknik është shprehur me vendimin:

Linja me dy qarqe Tirana 2-Rashbull të ndërtohet sipas variantit të dytë (konfigurimi B), pra njeri qark për tension 220 kV dhe qarku tjetër për tension 400 kV

Nga auditimi konstatohet se:

Si pasojë e ndryshimit të konfigurimit të òkomponentit Iò të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015, OST do të paguaj një kosto shtese për financimin e projektit me **141,726 euro** mbi vlerën e huas ose 2,431,963 euro më shumë se vlera e parashikuar ne raportin²³ final të konsulentit.

Disa prej anëtareve të këshillit teknik, nuk ishin dakord me implementimin e konfigurimit B, pasi sipas tyre, ky opsion do të rriste kostot e financimit me 141,726.36 Euro mbi vlerën e huas.

òZv/Kryetar²⁴ i këshillit teknik u shpreh se i përmbahej variantit të parë (konfigurimit A) pasi: vërtetë tendenca në perspektiv është për zhvillimin e rrjetit 400 kV, por edhe varianti i parë (konfigurimi A) nuk e përjashton këtë mundësi nëse perspektiva e zhvillimit e kërkon në të ardhmen. Rrjeti 220 kV tek ne është shumë i zhvilluar dhe do të mbetet ende në operim për një kohë të gjatëò

Për sa më lart për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, ish Administratori z. K..G... dhe znj. A...V..., në pozicionin e shefes së njësisë së zbatimit të projektit, pasi për periudhën respektive të ushtrimit të funksioneve të tyre brenda periudhës së auditimit, konstatohet që:

Ndryshimi i konfigurimit të komponentit I të marrëveshjes, me dy alternativa të ndryshme duhej të miratohej edhe në këshilli mbikëqyrës²⁵ për të marrë miratimin dhe autorizimin për tu pasqyruar në amendimin e marrëveshjes.

Përfshirja e konfigurimin A dhe B në dokumentet e tenderit për lotin 2, është bërë para shqyrtimit të tyre në mbledhjen e Këshillit Teknik të datës 12.11.2018.

²³ Raporti final nr. 2301 prot. datë 26.04.2017

²⁴ Ne këtë mbledhje kanë marrë pjesë 8 anëtarë të këshillit Teknik. Mbledhjen e kryesonte Zv. Kryetari i KT.

²⁵ Statuti i OST, neni 23 ò Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të këshillit mbikëqyrësò

Përfshirja e konfigurimit A dhe B në dokumentet e tenderit, është bërë pa vendim të këshillit Teknik.

Lidhja e kontratës me E... (lotin 2-konfigurimi B) ka krijuar një kosto shtesë prej 141,726.36 euro mbi vlerën e huas, ndërkohë nëse OST do të zgjidhte ofertën financiare sipas konfigurimit A për lotin 2, do të kursente 750,456 euro nga vlera totale e huas.

Oferta financiare e kontraktorit për lotin 2 pas negocimit është 2,431,963 euro më shumë se sa parashikimi²⁶ i konsulentit, në raportin²⁷ final të muajt prill 2017. Këshilli teknik për ndryshimin e konfigurimit të komponentit të parë me dy opsione respektivisht konfigurimi A dhe B, është mbledhur 3(tre) herë, ku vendimet e marra nga anëtarët e këshillit teknik për këtë çështje kanë qenë të ndryshme. Njësia e zbatimit të projektit në dakordësi me konsulentin kanë përfshirë në dokumentet e tenderit të miratuara dhe të dakordësuara me konsulentin në **datë 09.07.2017**, për lotin 2 edhe ÷Konfigurimin B÷ para se të miratohej në këshillin teknik, ku përfshirja e këtij opsioni, ishte objekt i shqyrtimit të njëpasnjëshëm të anëtarëve të këshillit teknik, i cili u miratua në **datën 23.11.2018**. Njësia e zbatimit të projektit në dakordësi me konsulentin, për lotin 2, kishte vendosur si kriter të vlerësimit financiar, paraqitjen nga ofertuesit të dy ofertave, respektivisht për konfigurimin A dhe për konfigurimin B.

Kriteri:

Marrëveshja e huas, statuti i shoqërisë, rregullorja e këshillit teknik, dhe detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në aparatën qendror të OST.

Shkaku:

Mungesa e vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës

Ndikimi/Efekti:

Vendimi i marrë nga Këshilli Teknik për ndryshimin e konfigurimit të ÷komponentit I÷ të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015, do të shtoj kostot e financimit të projektit me 141,726 euro mbi vlerën e huas ose 2,431,963 euro më shumë se vlera e parashikuar nga konsulenti.

Rëndësia:

E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3985/4 Prot. datë 28.07.2020 ÷Mbi Projekt Raportin e Auditimit÷ nga znj. A...V..., me detyre shefe e sektorit të njësisë së zbatimit të projektit pranë OST, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Konfigurimi B është propozuar nga konsulenti F... dhe megjithëse OST ka konfirmuar opsionin A pas mbledhjes së këshillit teknik, ka qenë ndërhyrja dhe insistimi i vazhdueshëm i Kry/ing te KfW z.R. K... që opsioni B të përfshihej në dokumentet e garës.

Pasi roli i bankës dhe i eksperteve të saj është mjaft aktiv dhe jo vetëm sugjerues/rekomandues në çdo fazë të tenderimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Audituesit shtetëror të KLSH janë shprehur për këtë koment në projekt raport, në përgjigje të objeksioneve të përcjella nga znj. A...V...me shkresën 2606/7 prot. date 26.06.2020 në lidhje me përfshirjen e "konfigurimit B" pa një vendim të Këshillit Teknik, në dokumentet e tenderit për "lotin 2", fakt që nuk kundërshtohet në të dy observacionet, por përkundrazi e përforcon atë, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

²⁶ Loti 2 është parashikuar: për konfigurimin A: 15,066,852 euro; për konfigurimin B: 15,973,445 euro

²⁷ Raporti final nr. 2301 Prot. datë 26.04.2017

B. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në Marrëveshjet me huadhënësit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) si institucioni përfitues i huas për shumën 40 milion euro, për realizimin e projektit "Eficenca energjetike-program për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike" në marrëveshjen e huas dhe komponentët e saj, ka përcaktuar kushtet dhe objektivat, që do të arrihen pas realizimit të projektit.

Objektivi kryesor i projektit është:

Rritja e efikasitetit të transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet shtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të nënstacioneve elektrike dhe linjave të transmetimit të tensionit të lartë, për të minimizuar humbjet teknike dhe për siguruar vazhdimësinë pa ndërprerje të transmetimit të energjisë elektrike.

Titulli i Gjetjes:

Mos percaktimi i afatit të ri për përfundimin e projektit "Eficenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike" në amendimet e bëra të marrëveshjes së huas.

Situata 5:

Në zbërthim të objektivit strategjik të projektit, në marrëveshjen e huas janë përcaktuar objektivat e mëposhtme:

Objektivi I - Niveli i ndikimit:

Kontributi në mbrojtjen globale të klimës përmes zvogëlimit të emetimeve të CO₂ dhe zhvillimit të një ekonomie të qëndrueshme.

Ky objektivi i vendosur përbën një objektivi strategjik të vendit tonë, mbi angazhimin për uljen e nivelit të emetimeve të CO₂ në mjedis duke investuar në rritjen e prodhimit të energjisë së gjelbër për të ndikuar në uljen e nivelit të ndotjes së ambientit.

Ky objektivi do të jetë i matshëm, pas realizimit dhe implementimit të projektit "Eficenca energjetike-program për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike" për të vlerësuar kontributin e këtij projekti në zvogëlimin e emetimit të CO₂ në ambient.

Objektivi II - Rezultatet

1. Rritja e kapacitetit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të Shqipërisë.

2. Rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit përmes një efikasiteti të shtuar dhe besueshmërisë së sistemit të transmetimit në Shqipëri.

Objektivi II ka të bëjë me arritjen e rezultateve të pritshme në drejtim të rritjes së fuqisë së transmetimit të energjisë elektrike, sigurisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Bazuar në treguesit e performancës për vlerësimin sasior të këtij objektivi, parashikohet që kapaciteti i transmetimit në rrjetën midis Tiranë - Rrashbull dhe Fier të rritet me të paktën 155 MW në vitin e dytë të funksionimit të dy komponentëve.

Ky objektivi nuk është arritur pasi projekti nuk është implementuar.

Objektivi III-Realizimi në kohë

Realizimi në kohë i implementimit të projektit për të dy komponentët sipas parashikimeve të marrëveshjes.

Në marrëveshjen e veçantë të Huas së datës 02.07.2015, në aneksin 2 të saj, është përcaktuar skeduli kohor i realizimit të projektit:

Projekti është parashikuar të zbatohet përgjatë viteve 2015 - 2018.

Faza e zbatimit për Komponentin I vlerësohet të zgjasë 3 vjet, deri në fund të vitit 2017.

Faza e zbatimi për Komponentit II vlerësohet të zgjasë katër vjet deri në fund të vitit 2018.

Ky objektivi nuk është realizuar dhe shtyrja në kohë e realizimit të këtij projekti, është shoqëruar me kosto të shumta shtesë mbi vlerën e huas.

Afati i ri për realizimin e këtij projekti sipas dy komponentëve nuk është pasqyruar në amendimet e marrëveshjes së veçantë.

Grupi i audituesve shtetëror të KLSH, afatin e realizimit të këtij projekti e ka konstatuar gjatë, shqyrtimit të kontratave të kontraktorëve.

Në kontratën nr. 7857 Prot., datë 14.11.2018 të kontraktorit òE...ò, afati i përfundimit të punimeve të Lotin 1, Seksioni I (Rikonstruksion i dy nënstacion ekzistuese Rrashbull dhe Tirana 2) është përcaktuar data 28.03.2021 dhe për Seksionin e dytë (Ndërtimi i nënstacionit Tirana 3) është përcaktuar data 28.03.2022. Në kontratën nr. 8795 Prot. datë 27.12.2018 për Lotin 2 me kontraktorin E... për seksionin II (linja 110 KV OHL+kabllore) është parashikuar afati i përfundimit data 23.04.2021 dhe për seksioni I (Tirana2-Rashbull) është parashikuar afati i përfundimit data 03.06.2022.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi, ish Administratori z. K...G., ish drejtori i DIPI z. L... K..., ish Drejtori i Projekteve te Huaja DPH z. K... S... dhe znj. A... V... në pozicionin e shefes së njësisë se zbatimit te projektit, për periudhën respektive të ushtrimit të funksioneve të tyre brenda periudhës se auditimi, pasi me veprimet apo mos veprimet e tyre kane ndikuar ne mos realizimin e objektivave te vendosura ne marrëveshjen e huas për projektin eficenca energjetike ne sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Kriteri: Marrëveshja e huas, raportet e konsulentit.

Shkaku: Ndër shkaqet kryesore të mos realizimit në kohë të projektit është realizimi i procedurës së parë të tenderit për zgjedhjen e konsulentit për shkaqe subjektive dhe të pa justifikueshme të OST

Ndikimi/Efekti: Mos realizimi në kohë i zbatimit të projektit do te shoqërohet me kosto shtesë mbi vlerën e huas.

Rëndësia: E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3985/4 Prot. datë 28.07.2020 òMbi Projekt Raportin e Auditimitò nga znj. A...V... me detyre shefe e sektorit te njësisë se zbatimit te projektit pranë OST, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Meqenese me amendimin e dyte te marrëveshjes te datës 27.09.2019, eshte bere shtyrja e afatit te fundit per te kërkuar disbursime deri me date 31.12.2022, nënkupton qe edhe afati per përfundimin e projektit vjen ne sikron me kete shtyrje dhe rrjedhimisht afati i parashikuar ne marrëveshjen e vecante-viti-2018-s'mund te merret e mireqene si afat per përmbylljen e projektit.

Ju sqarojmë se ne takimin me KfW eshte rene dakord ne parim qe ndryshime te tilla qe janë te ndërlidhura me ecurinë e projektit (kohore, financiare, teknike) te përmbliidhen ne nje amendim gjithë përfshirës te Marreveshjes se vecante. Nga eksperiencia jone si PIU, sikurse eshte vepruar edhe ne projekte te mëparshme te financuara nga kjo banke, ky amendim mund

te behet ne kohenkur projekti t'i afrohet mbylljes, me qellim per te shmangur sa me shume te jete e mundur amendime te njepasnjeshme te këtyre dy marrëveshjeve.

Qëndrimi i grupit te auditimit

Afati i ri për realizimin e këtij projekti sipas dy komponentëve nuk është pasqyruar në amendimet e marrëveshjes së veçantë. Grupi i audituesve shtetëror të KLSH, afatin e realizimit të këtij projekti e ka konstatuar gjatë, shqyrtimit të kontratës të "E..." nr. 7857 Prot., datë 14.11.2018 dhe në kontratën me "E..." nr. 8795 Prot. datë 27.12.2018. Afati i ri për përfundimin e fazës së implementimit të projektit nuk është pasqyruar në asnjë amendim të marrëveshjes, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

C. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

C.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në menaxhimin financiar të Projektit.

Për menaxhimin financiar të Projektit dhe nivelin e realizimit të disbursimeve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Marrëveshja e Huas si edhe Amendimet e saj.

-Dokumentacioni financiar i mbajtur nga Njësia e Zbatimit të Projektit;

-Dokumentacioni mbi disbursimet e kryera midis Huamarrësit (OST) dhe Huadhënësit banka gjermane (Kf).

-Dokumentacioni financiar i mbajtur nga Drejtoria Ekonomike e OST mbi pagesat e kryera për detyrimet e kredisë; etj.

Me ligjin nr. 88/2015, miratuar më 23.07.2015 shpallur me dekretin nr. 9200, datë 30.07.2015, është ratifikuar marrëveshja e Huas midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin ÷Efienca energjetike për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike, financuar në shumën 40,000,000 Euro nga Banka gjermane Kf . Huaja që do të jepet në bazë të kësaj Marrëveshje dhe programi është vendosur në kuadrin e transmetimit të programit të sektorit të efikasitetit të energjisë, që do të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në transmetimin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

Referuar përcaktimeve në Marrëveshjen e Huas, Huamarrësi, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) do të përdorë kredinë ekskluzivisht për të financuar zbatimin e infrastrukturës së transmetimit për linjën e transmetimit Tiranë - Rrashbull (Komponenti I), linjën e transmetimit Unaza e Tiranës (Komponenti II) dhe shërbimet e konsulencës, si më poshtë:

Tabela nr. 2

Në Euro

Komponentët	Shuma e Huas
Linja e transmetimit Tiranë - Rrashbull (Komponenti I),	16,750,000
Linja e transmetimit Unaza e Tiranës (Komponenti II)	23,500,000
Konsulenca	2,250,000
Kontigjenca	2,500,000
SHUMA	45,000,000

Burimi: Marrëveshja e Huas

Detyrimet e kredisë sipas Marrëveshjes janë përcaktuar në Nenet 1 ÷Huajaö dhe 3 ÷Tarifatö. Taksat, tarifat dhe detyrimet doganore nuk do të financohen nga huaja. Tarifa e angazhimit e përcaktuar në nenin 3.1 të Marrëveshjes, ku Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme prej 0, 25% vjetor mbi shumat e pa disbursuara të Huas. Afatet e pagesës janë përcaktuar 30 qershor dhe 30 dhjetor, pagesat fillojnë më 30 qershor të vitit 2015.

Tarifa e menaxhimit e përcaktuar sipas Marrëveshjes në nenin 3.2 ku Huamarrësi do të paguajë Kf -së një tarifë menaxhimi të pakthyeshme prej 1% të shumës së Huas, e cila duhet të paguhet 3 muaj pas nënshkrimit të saj.

Norma e interesit të Huas është përcaktuar prej 1,7%. Pagesat e principalit janë parashikuar në 18 këste të fillojnë në datën 30.06.2018 - 30.12.2026.

Detyrimet e Kredisë deri 23.12.2021, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3 Në Euro

Vitet	Periudha	Pagese Principali	Pagesa interesi	Tarifa e menaxhimit	Tarifë kompensimi	Tarifë angazhimi
2015	6 mujori I					
	6 mujori II			400,000		25,000
2016	6 mujori I					50,000
	6 mujori II					50,000
2017	6 mujori I		500			49,927
	6 mujori II		3,608			49,469
2018	6 mujori I		5,286			49,223
	6 mujori II		5,286			49,223
2019	6 mujori I		23,369			46,563
	6 mujori II		41,148		377,519	43,948
2020	6 mujori I		43,725			43,570
	6 mujori II		48,548			42,861
2021	6 mujori I	308,649	58,567			41,387
	6 mujori II		-			-
Totali		308,649	230,037	400,000	377,519	541,171

Burimi: OST, Marrëveshja e Huas dhe llogaritje të grupit të auditimit

Referuar tabelës si më lart, detyrimet e kredisë deri në 6 mujorin e parë 2021 nga detyrimi principal në shumën 2,200,000 Euro, janë paguar 308,649 Euro, ose janë shlyer 1,891,351 Euro me pak; janë paguar interesa në shumën 230,036.⁷⁹ Euro; janë paguar 400,000 Euro tarifë menaxhimi dhe 541,171.⁰⁶ Euro tarifë angazhimi, si edhe pagesa prej 377,519 Euro tarifë kompensimi e cila është paguar nga fondet e OST në favor të bankës KfW në datën 04.10.2019 si detyrim për vonesat në disbursime.

Në datën 29.06.2018 është nënshkruar amendimi i parë i Marrëveshjes së Huas referuar skedulit të ripagesave, duke lënë të pandryshuar termat e tjerë të saj.

Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST nr. 388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Banka Kf , me letrën e datës 26.08.2019, ka pranuar në parim shtyrjen e afatit të disbursimit, por thekson pagesën e një vlerë kompensimi si pasojë e shtyrjes së afatit të disbursimit, ku Huadhënësi pranon se kjo vlerë është bazuar në kushtet e tregut të kapitalit që ka preluar në kushtet e llogaritjes së kësaj vlere, duke theksuar se asnjë kosto shtesë nuk përfshihet në vlerën prej 861,206 Euro. Kf në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë me OST pranon të mbulojë 50% të shumës dhe pjesa tjetër të mbulohet nga OST, dhe për këtë nuk ka asnjë llogaritje ose mënyra e llogaritjes nga banka Kf për caktimin e vlerës prej 377,519 Euro. Huamarrësi (OST) ka rënë dakord për të paguar detyrimin e paraqitur nga banka Kf dhe ka likuiduar vlerën **377,779 Euro** (377,519 Euro + 260 Euro komision banke), **e cila përbën kosto shtesë për OST**. Për këtë vlerë nuk është paraqitur nga Kf asnjë dokument për mënyrën e llogaritjes si edhe nga Drejtoria Ekonomike e OST nuk disponohet dokumentacion mbi përcaktimin e vlerës.

Referuar Marrëveshjes së nënshkruar nga palët me amendimet përkatëse plani i disbursimeve është shtyrë deri në korrik të vitit 2022, ose me 3 vjet nga afati i parashikuar si pasojë e vonesave të ardhura nga procedurat e tenderimit. Vlera e detyrimit në favor të Kf është kontabilizuar në llogarinë 233 ÷ Investime të projektit, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.8, datë 17.02.2003 ÷ Për evidentimin regjistrimin, përdorimin dhe

raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huajë.

C.2. Mbi realizimin e disbursimeve të Projektit, në krahasim me disbursimet e planifikuara.

Plani i Disbursimeve sipas amendamentit të Marrëveshjes datë 29.06.2018, si mëposhtë:

Tabela nr. 4 Në Euro

Nr	Periudha	Shuma e programuar	Shuma e pa disbursuar	Tarifa e angazhimit
1.	30.06.2015 ó 1.01.2018	621,936	39,378,064	98,445
2.	1 Janar 2018 - 1 Korrik 2018	1,000,000	39,000,000	97,500
3.	1 Korrik 2018 - 1 Janar 2019	11,000,000	29,000,000	72,500
4.	1 Janar 2019 - 1 Korrik 2019	17,000,000	23,000,000	57,500
5.	1 Korrik 2019 - 1 Janar 2020	23,500,000	16,500,000	41,250
6.	1 Janar 2020 - 1 Korrik 2020	27,000,000	13,000,000	32,500
7.	1 Korrik 2020 - 1 Janar 2021	31,500,000	8,500,000	21,250
8.	1 Janar 2021 - 1 Korrik 2021	37,000,000	3,000,000	7,500
9.	1 Korrik 2021 - 1 Janar 2022	39,000,000	1,000,000	2,500
10.	1 Janar 2022 ó 1 Korrik 2022	40,000,000	-	430,945

Burimi: Marrëveshja e Huas dhe llogaritje të grupit të auditimit

Tarifa e angazhimit e përcaktuar në nenin 3.1 të Marrëveshjes, ku Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme prej 0, 25% vjetor mbi shumat e pa disbursuara të Huas. Afatet e pagesës janë përcaktuar 30 qershor dhe 30 dhjetor, pagesat fillojnë më 30 qershor të vitit 2015. Tarifa e angazhimit deri në momentin e mbajtjes së Aktverifikimit nr. 1, datë 23.12.2021, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 5 Në Euro

Vitet	Tarifë angazhimi		Diferencat
	Programi	Fakti	
2015	-	25,000	+25,000
2016	-	100,000	+100,000
2017	98,445	99,396	+951
2018	170,000	98,446	-71,554
2019	98,750	90,512	-8238
2020	53,750	86,431	+32,681
2021	10,000	41,387	+31,387
2022	-	-	-
Shuma	430,945	541,171	110,227

Burimi: OST, Marrëveshja e Huas dhe llogaritje të grupit të auditimit

Sipas pagesave të kryera dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë, pagesat për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2019 janë në vlerën **110,227 Euro më tepër nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin**. Kështu, deri në muajin Qershor të vitit 2021, nga OST është paguar tarifë angazhimi në vlerën 541,171Euro, e cila deri në përfundim të projektit ishte parashikuar në vlerën 430,945 Euro, pra zgjatja e afatit të disbursimeve edhe me 2 vjet shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit.

Disbursimet e realizuara gjatë viteve 2015-2021 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 6 Në Euro

Vitet	Monedha	Disbursime	Pa disbursuar	Komisione te paguara	Interes i paguar
2015	EUR			25,000	
2016	EUR			100,000	
2017	EUR	621,936		99,396	4,108
2018	EUR	-		98,446	10,572
2019	EUR	4,429,458		90,512	64, 517

2020	EUR	1,775,711.16		86,430.50	92,272.69
2021	EUR	734,142.44		41,387.50	58,567.07
Totali	EUR	7,561,247.70	32,438,752.30	541,171.06	230,036.79

Burimi: OST, Marrëveshja e Huas dhe llogaritje të grupit të auditimit

Referuar tabelës sa më sipër, shuma e disbursuar deri më datë 23.12.2021, është 7,561,247 Euro, ku shuma e pa disbursuar është në nivelin e 32,438,752 Euro, ose 19% e shumës së kredisë, komisionet e paguara janë në shumën prej 541,171 Euro dhe interesa të paguar në shumën 230,037 Euro pagesa interesi. Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim, megjithëse projekti ishte parashikuar të përfundonte në dhjetor të vitit 2018, por aktualisht nuk ka filluar faza e implementimit, pra realizimi i projektit është me shumë vonesë.

Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST nr. 388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Në datën 29.06.2018 është nënshkruar amendimi i parë i Marrëveshjes së Huas referuar skedulit të ripagesave, duke lënë të pandryshuar termat e tjerë të saj.

Miratimi për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2022, me ritmet e realizimit të projektit, nuk do të jetë i mjaftueshëm, nisur nga ecuria dhe problematikat në faza të ndryshme të projektit dhe ku ende nuk kanë filluar punimet.

Për realizimin e projektit janë nënshkruar 3 kontrata, 1 kontratë për shërbime konsulence dhe 2 kontrata për implementimin e projektit, ku disbursimet e detajuara sipas kontraktorëve deri më 23.12.2021, paraqiten si më poshtë

Tabela nr. 7

Në Euro

Kontratat	Vlera fillestare	Vlera e ndryshuar	Disbursuar deri në 23.12.2021	Disbursuar në %
E... d.d S...-Loti II	18,405,408	18,320,418.36	1,968,670.10	11
E... E... e S..., S.A óLoti I	19,277,703	19,277,703.00	3,855,540.60	20
K..., F...	2,458,615	2,623,615.00	1,737,037.00	66
Totali	40,141,726		7,561,247.7	18.8
Huaja	40,000,000			
Vlera e mbetur	141,726			

Burimi: OST, Marrëveshja e Huas dhe llogaritje të grupit të auditimit

1. Kontrata për shërbimin e konsulencës nënshkruar me konsulentin òF...ò në vlerën 2,458,615 Euro, me afat implementimi 48 muaj. Janë kryer pagesat në vlerën 1,737,037 Euro, ose në masën 66% të vlerës së kontratës. Kontrata për shërbimin e konsulencës është nënshkruar në vlerën **208,615 Euro** më të lartë se parashikimi (2,458,615 - 2,250,000) duke shtuar kostot e projektit.

2. Kontrata për kryerjen e punimeve, nënshkruar me operatorin òE...E... e S... S.Aö, në vlerën 19,277,703 Euro; me afat zbatimi për Seksionin 1 prej 24 muaj dhe për Seksionin 2 parashikon afatin e zbatimit prej 36 muaj. Kjo kontratë është amenduar, duke përcaktuar si afat të përfundimit të punimeve: për Seksionin 1 është përcaktuar data 28.03.2021 dhe për Seksionin 2 më datë 28.05.2022. Janë kryer pagesat për kontraktorin òE... E... e S..., S.Aö, në vlerën 3,855,540 Euro, ose paradhënie masën 20% të vlerës së kontratës.

3. Kontrata për kryerjen e punimeve nënshkruar me operatorin òE... d.d S...ö, në vlerën 18,405,408 Euro, me afat zbatimi për Seksionin 1 prej 24 muaj dhe për Seksionin 2 parashikon afatin e zbatimit 36 muaj. Janë kryer pagesa për kontraktorin òE... d.d S...ö, në shumën 1,968,670.¹⁰ Euro, ose 11% e vlerës së kontratës.

C.3. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në raportimet financiare dhe jo financiare.

Sipas parashikimit në Marrëveshje, neni 1 òHuajaö taksat, detyrimet doganore, tarifata e tjera publike që i detyrohen huamarrësit, nuk do të financohen nga kredia. Pagesat e TVSH-së për

projektin "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", në masën 20% të vlerës së punimeve dhe shërbimeve të konsulencës, janë kryer në afate nga OST. Deri më 23.12.2021 është paguar detyrimi për TVSH si më poshtë:

Tabela nr. 8

Në lekë

Emërtimi	Vlera TVSH	Pagesa
Shërbim Konsulence	52,959,904.67	52,959,904.67
Punime civile	35,660,785.19	34,383,676.00
Totali	88,620,689.86	87,343,580.67

Burimi: OST dhe llogaritje të grupit të auditimit

Nga njësia e zbatimit të projekteve janë kryer raportimet periodike pranë bankës Kf dhe Ministri sipas përcaktimeve në Marrëveshjen e huas.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Deri në përfundim të auditimit është disbursuar **19%** e kredisë në një kohë që është konsumuar koha e efektshmërisë së përdorimit të Huas sipas Marrëveshjes. Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara, ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.

-Projekti ishte parashikuar të përfundonte në dhjetor të vitit 2018, por ende nuk ka filluar faza e implementimit.

-Miratimi për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2022, nuk do të jetë i mjaftueshëm, nisur nga ecuria dhe problematikat në faza të ndryshme të projektit ku ende nuk kanë filluar punimet.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në:

-Marrëveshjen e Huas miratuar me ligjin nr. 88/2015, më 23.07.2015 shpallur me dekretin nr. 9200, datë 30.07.2015 dhe ngarkojnë me znj. A... V..., me detyrë shefe e NJZP, Z. A... K..., me detyrë Drejtor Ekonomik, znj. J... K..., ish financiere e NJZP (13.03.2015-08.04.2019).

Titulli i gjetjes:

Situata 1:

Vlera shtesë e kontratës së konsulentit

Kontrata për shërbimin e konsulencës nënshkruar me konsulentin òF...ò në vlerën 2,458,615 Euro, me afat implementimi 48 muaj, është nënshkruar në vlerën **208,615 Euro më të lartë se parashikimi(2,458,615 - 2,250,000), vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin.**

Kriteri :

Ndikimi:

Shkaku:

Rëndësia:

Marrëveshja e Huas

Rritje e kostos së Projektit

Mosrespektimi studimit të fizibilitetit

E lartë

Titulli i gjetjes:

Situata 2:

Penaliteti për shtyrjen e afatit të disbursimeve.

Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST Nr.388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Banka Kf , me letrën e datës 26.08.2019, ka pranuar në parim shtyrjen e afatit të disbursimit, por thekson pagesën e një vlerë kompensimi si pasojë e shtyrjes së afatit të disbursimit, ku Huadhënësi pranon se kjo vlerë është bazuar në kushtet e tregut të kapitalit që ka preluar në kushtet e llogaritjes së kësaj vlere, duke theksuar se asnjë kosto shtesë nuk përfshihet në vlerën prej 861,206 Euro. Kf në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë me OST pranon të mbulojë 50% të shumës dhe pjesa tjetër të mbulohet nga OST, dhe për këtë nuk ka asnjë llogaritje ose

	<p>mënyra e llogaritjes nga banka Kf për caktimin e vlerës prej 377,519 Euro. Huamarrësi (OST) ka rënë dakord për të paguar detyrimin e paraqitur nga banka Kf dhe ka likuiduar nga fondet e OST, vlerën 377,779 Euro (377,519 Euro + 260 Euro komision banke), duke shtuar kostot për OST. Për këtë vlerë nuk është paraqitur nga Kf si edhe nuk është kërkuar asnjë dokument për mënyrën e llogaritjes, nga Drejtoria Ekonomike e OST nuk disponohet dokumentacion mbi përcaktimin e vlerës.</p>
Kriteri :	Marrëveshja e Huas
Ndikimi:	Rritje e kostos së Projektit
Shkaku:	Mosrespektimi afateve të disbursimeve
Rëndësia:	E lartë
Titulli i gjetjes:	Vlera shtesë për tarifën e angazhimit
Situata 3:	<p>Sipas pagesave të kryera dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, pagesat për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2019 janë në vlerën 110,227 Euro më tepër nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin. Po kështu, deri në përfundim të auditimit, nga OST është paguar vlera 541,171 Euro, e cila deri në përfundim të projektit ishte parashikuar në vlerën 430,945 Euro, pra zgjatja e afatit të disbursimeve edhe me 2 vjet shoqërohet me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit, vlerë e cila do të jetë në rritje.</p>
Kriteri :	Marrëveshja e Huas
Ndikimi:	Rritje e kostos së Projektit
Shkaku:	Mosrespektimi i planit të tarifës së angazhimit
Rëndësia:	E lartë
Titulli i gjetjes:	Vonesat në implementimin e projektit dhe nivelin e disbursimeve
Situata 4:	<p>Shuma e disbursuar deri në datën 23.12.2021 është 7,561,247 Euro, ku shuma e pa disbursuar është në nivelin e 32,438,752 Euro, ose 19% e shumës së kredisë.</p> <p>-Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.</p> <p>-Projekti është parashikuar të përfundojë në dhjetor të vitit 2018 dhe ende nuk ka filluar faza e implementimit, pra projekti është me 3 viti vonesë deri në periudhën e auditimit, datë 23.12.2021. Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST nr.388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Në datën 29.06.2018 është nënshkruar amendimi i parë i Marrëveshjes së Huas referuar skedulit të ripagesave, duke lënë të pandryshuar termat e tjerë të saj.</p> <p>-Miratimi për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2022, nuk do të jetë i mjaftueshëm, nisur nga ecuria dhe problematikat në faza të ndryshme të projektit, ku ende nuk kanë filluar punimet.</p>
Kriteri :	Marrëveshja e Huas
Ndikimi:	Rritje e kostos së Projektit

Shkaku: Vonesa në implementimin e projektit
Rëndësia: E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 3985/1, datë 28.07.2020 Mbi Projektraportin e Auditimit nga znj.A...V..., z.A... K..., znj.I... S... dhe znj.A... A..., ku janë shprehur objeksionet si mëposhtë:

Pretendimi i subjektit: *Shtyrja e afatit të disbursimeve deri në dhjetor të vitit 2022, i cili sipas tabelës nuk është shënuar me datë fikse, por është lënë i papërcaktuar në varësi të afatit të fundit për të kërkuar disbursime.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar

Sa i takon afatit të kërkuar për disbursime, sqarojmë se skeduli i planit të disbursimeve në Amendimin e marrëveshjes është caktuar 30 qershor 2022, e konfirmuar edhe nga tabela e disbursimeve. Pra, grupi i auditimit i referohet tabelës sipas Amendimit të dytë të marrëveshjes së huas, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: *Kontrata e konsulencës është lidhur me vlerë më të ulët se parashikimi në marrëveshje në datën 13.09.2016 dhe shtesa e kontratës lindi si nevojë për aktivizimin e opsionit 1 ka dalë në mbledhjen me konsulentin në datën 20.10.2016.....dhe u ra dakord në minutat e takimit datë 22.12.2016*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Sa i takon pretendimit se shtesa e kontratës është bërë pasi lindi nevoja për punime shtesë, sqarojmë se kjo vlerë është parashikuar në kontratën e nënshkruar nga palët më 13.09.2016 në “Kushtet e veçanta” Ad.5.1.1 “Pagesat”po kështu edhe kontrata shtesë datë 24.03.2017, parashikon vetëm mënyrën e disbursimit të kësaj shtese.Pra, vlera e kontratës shtesë është parashikuar në kontratën fillestare. Ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

Pretendimi i subjektit: *Vonesat e projektit nuk janë shkaktuar nga vonesa në fatura/hapave të përcaktuara në marrëveshjen e veçantë.....dhe se afati 3 vjeçar ka qenë parashikues....po kështu vonesat janë si pasojë e kohës për procedurat e përzgjedhjes së konsulentit dhe kontraktorëve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Sa më lart sqarojmë se grupi i auditimit nuk është shprehur se vonesat në realizimin e afatit të implementimit të projektit janë nga vonesat në disbursime por pikërisht nga tejzgjatja dhe problematikat në tenderime, etj.*

Ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: *Në marrëveshjen e huasnë nenin 2.6 parashikohet se huamarrësi(OST)do t'i paguajë Huadhënësit(KfW)menjëherë sipas kërkesës së saj shumë e nevojshme për të gjitha humbjet shpenzimet dhe kostot.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Sa i takon vlerës së penaltetit nga KfW, sqarojmë se grupi i auditimit nuk është shprehur se kjo rrjedh për fajin e KfW por ka kërkuar justifikimin e kësaj vlere, mënyrën e llogaritjes, pra njohjen e këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe kostove si edhe kontabilizimin e veprimit referuar legjislacionit në fuqi.*

Ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

D. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësit, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra dhe shërbime deri në lidhjen e kontratës.

Për zbatimin e procedurave të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Raporte vlerësimi.

-Korrespondenca elektronike (e-mail) me KfW .

-Proces-verbale të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave.-Urdhra të Administratorit OST etj.

-Udhëzuesi për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet partnere (publikuar nga Kf -2013).

-Udhëzuesi për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere.

-Marrëveshje e Veçantë si pjesë integrale e marrëveshjes së huasë.

Për këtë projekt janë kryer 3 procedura prokurimi, prej të cilave 1 për zgjedhjen e konsulentit dhe 2 për zgjedhjen e kontraktorëve. Për realizimin e programit të auditimit është përdorur metoda e testimit hap pas hapi.

Projekti **Ref.BMZ Nr.2011.66.388** ÷Eficiencia energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike është përbërë prej dy komponentëve si më poshtë:

I. Ndërtimi i linjës ajrore të re ÷220kV me dy qarqe Tiranë - Rrashbullë përfshirë zgjerimin e nënstacionit elektrik Tirana 2 (dalje e re 220kV) dhe përforcimi dhe zgjerimi i nënstacionit elektrik Rrashbull (dalje e re 220 kV dhe zëvendësimi i transformatorëve të fuqisë 220/110 kV).

II. Zgjerimi i rrjetit të transmetimit 110kV ÷Unaza 110 kV e Tiranësë. Kjo mbulon ndërtim/përforcimin e linjave të transmetimit Tirana 1-Uzina ÷Traktorië-Tirana 3, Tirana 3-Selita dhe Tirana 3-Farka. Seksione të linjës transmetimit përmes zonave me dendësi popullore (1 km drejt nënstacionit Selitës dhe 6km drejt nënstacionit ÷Uzina Traktorië do jenë linjë kabllore. Gjithashtu, përfshihet lidhja me linjën e transmetimit 400kV Tirana-Elbasan, nëpërmjet ndërtimit të nënstacionit të ri 400/110kV Tirana 3.

1. Prokurimi i shërbimit të konsulentit

Procesi i prokurimit është zhvilluar në dy faza. Për Fazën e parë, atë të para-kualifikimit afati për dorëzimin e dokumenteve për shprehjen e interesit ishte caktuar në datën 27 shkurt 2015 ora 15:00.

Në zbatim të paragrafit 1.05 të ÷Udhëzimit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnere, për të ndihmuar në përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të tenderimit, është caktuar nga banka si Agjent i Tenderit shoqëria I... C&S.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr.533/5 datën 26.02.2015 të Administratorit të OST z. E...Z... është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me Kryetar z ...D... dhe anëtarë znj. I...N..., znj. A...V..., z. G... D..., z. A... S..., znj. J... K...

Me raportin e vlerësimit nr.533/7 prot., datë 23.03.2015 janë kualifikuar për fazën e parë aplikantët si më poshtë:

Nr.	Firmat konsulente	Ekspierienca e përshtatshme	Përshtatshmëria me projektet	Pikët total
	Pikët Max.	45	55	100
I	F...	39.50	48.61	88.11
II	C...C...-D...	38.00	44.91	82.91
III	A.F...C... S...Ltd.	33.50	36.89	70.39
IV	I... (G...-I... R...)	40.50	44.20	84.70

Me e-mailⁱⁿ e datës 05.05.2015 është dhënë dakordësimi (no-objection) i KF për fazën e para-kualifikimit.

Afati i dorëzimit të ofertave për fazën e shqyrtimit teknik dhe financiar është caktuar në datën 21 Gusht 2015.

Në datën 12 Gusht 2015, nga ofertuesi F... është paraqitur një kërkesë për zgjatje të afatit për dorëzimin e dokumenteve të propozimit teknik dhe financiar, e cila është pranuar nga agjenti i tenderit dhe është aprovuar nga OST, duke e zgjatur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 28 Gusht 2015.

Në proces-verbalin nr.4944 prot., datë 26.08.2015, ora 16:20, i mbajtur nga z. Y...D...Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit është deklaruar hapja gabimisht, nga ana e punonjësës së protokollit, e kutisë dhe e zarfit të ofertës ekonomike për ofertuesin M..V...V.. D...-C...

Por, me e-mail e datës 26 Gusht 2015 ora 14:05 nga Njësia e Zbatimit të Projekteve (PIU) të OST është njoftuar agjenti i tenderit për mbërritjen e ofertave të aplikantëve F..., C...

M...V...V ...D... dhe G... I... Në këtë mënyrë, kjo njësi duhej të kishte marrë masat për ruajtjen e tyre në gjendje të vulosur deri në momentin e hapjes në datën 28 Gusht 2015.

Hapja e ofertës sa më sipër është kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në pikën 2.3, paragrafi 2.12 ÷Udhëzuesi për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnereö, ku përcaktohet se: *Oferta e shërbimeve do të jetë hapur menjëherë pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Zarfet, që përmbajnë kuotimet e çmimeve do të mbahen të vulosur dhe do të jenë hapur vetëm me miratimin e KfW për ato ofertues, që kanë arritur të paktën 75 % të pikëve*

Me shkresën Nr.5056 Prot. datë 1/09/2015, të Administratorit të OST z. E... Z... është njoftuar përfaqësuesi i KF (Banka për Evropën Juglindore dhe Turqinë) mbi ngjarjen e ndodhur sa më sipër, si edhe është kërkuar njëkohësisht anulimi i procedurës së tenderit për shërbimin e konsulentit.

Në aneksin 2 bashkëlidhur ÷Udhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnereö, pika 2, paragrafi *përpara një anulimi të mundshëm të tenderit* është parashikuar se: propozimi nga klienti që tenderi të anulohet duhet të jetë me arsyetim. Kjo duhet të ndjekë kriteret e këtij Udhëzuesi dhe duhet të shoqërohet me dokumentet përkatëse si kërkohet nga Kf .

Por, kërkesa për anulimin e tenderit nuk ka ardhur për asnjë nga rastet e parashikuara në Paragrafin 2.6 në ÷Udhëzimin për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnereö kur:

- a) nuk ka patur konkurrencë të mjaftueshme;
- b) asnjë nga ofertat nuk ka arritur minimumin e pikëve;
- c) Kanë ndryshuar aspekte teknike dhe financiare bazë përpara lidhjes së kontratës;
- d) kuotimet e çmimit janë mjaft të dukshme të larta. Në këtë rast alternative është ose mbajtja e një procedure tenderi të re, ose nisje e negociatave mbi çmimin me ofertuesin i cili vjen i pari;

Sa sipër, për shkak të mangësive në menaxhimin e procedurave të tenderit ka dështuar procesi i vlerësimit të ofertave. Gjithashtu, përsëritja e procesit të tenderit për arsye subjektive ka sjellë vonesa të theksuara për rreth 1 vit për realizimin e procedurës së tenderit për caktimin e konsulentit.

Në përgjigje të shkresës Nr.5056 Prot. datë 1/09/2015, të Administratorit të OST, në datën 2 Tetor 2015 KF ka miratuar përsëritjen e gjithë procesit të prokurimit dhe nga ana e bankës është kërkuar përgatitja e një seti të ri dokumentesh për tender si dhe një listë masash të përshtatshme për të siguruar një process prokurimi të kënaqshëm në të ardhmen.

Në datën 18 Dhjetor 2015 është ri-publikuar në GTAI njoftimi për procesin e para-kualifikimit dhe afati i dorëzimit të dokumenteve është caktuar data 27 Janar 2016.

Në muajin Mars 2016 është dorëzuar raporti i vlerësimit të përzgjedhjes së ofertuesve.

Nga vlerësimi i dokumentacionit para-kualifikues, nga shtatë aplikantë, katër prej tyre kanë arritur më shumë se 70 pikë. Tre aplikantë the J... V... G...-C... (G.../I...), G... (G...) dhe the C.. T... H...-R...-G... (G...) nuk arritën limitin e 70 pikëve si kërkesë minimale.

Aplikantët, që kanë arritur të marrin pikët e mundshme (kufiri i kërkuar), janë treguar në tabelën si më poshtë:

Nr.	Firmat Konsulente	Eksperiencia e përshtatshme	Përshtatshmëria me projektet	Pikët total
	Pikët Max.	45	55	100
I	F...	37	45.51	82.51
II	C...C...-D...	36	43.21	79.21
III	A...F...C... S...Ltd.	31	46.64	77.64
IV	I...(G...-I... R...)	36	41.35	77.35

Në datën 2 Qershor 2016 është kryer hapja e zarfeve të dorëzuar brenda afatit të caktuar 30 Maj 2016 tek tender agjent dhe 1 Qershor 2016 kopja e këtyre dokumenteve tek OST.

Nga ofertuesit në garë, vetëm nga aplikanti F... GmbH & Co është arritur kufiri i vlerësimit teknik (82.51 pikë), ndaj edhe rekomandimi në draft raportin e vlerësimit teknik dërguar KF -së është kërkuar që të procedohet më tej me hapjen e propozimit financiar vetëm të këtij ofertuesi.

Në datën 10 Gusht 2016 është dhënë nga banka dakordësimi(No-Objection) për raportin e vlerësimit financiar. Kontrata e konsulencës është lidhur me nr.5227 prot. në datën 13.09.2016.

2. Prokurimi i përzgjedhjes së kontraktorëve

Procedura e mësipërme përfshin të dy komponentët e projektit I dhe II ÷Eficiencia energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike, duke i ndarë në Lot-1 (N/Stacionet) dhe Lot-2 (Linjat).

Procedura për Lot-1.

Data e dorëzimit të dokumenteve për **Lot-1** (N/Stacionet), për fazën e para-kualifikimit është përcaktuar 25 Janar 2017.

Me Urdhrin nr.53/2 datë 16.01.2017, të Administratorit të OST është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me Kryetar z. L... K...dhe anëtarë znj. A...V..., znj. A... P..., znj. J...K... dhe z. A... N...

Drejtoria e Projekteve të Huaja si edhe NJZP janë ngarkuar të ndjekin dhe koordinojnë procedurat me konsulentin dhe bankën.

Në procesverbalin të mbajtur nga KVO nr.53/8 prot. datë 06.04.2017, kanë kaluar fazën e parë të para-kualifikimit si më poshtë:

- K... P... P... E... T...E... Inc. është kualifikuar pa kushte;

-A... S.p.A, E... E... e S..., C... G.. G... GmbH M... S.A me kushtin, që mangësitë respective të konstatuara do të rregullohen në fazën vijuese të tenderit.

Dakordësimi(No-Objection) i Kf për këtë fazë është bërë i ditur nga e-mail i datës 05.05.2017. Kompanitë që kanë kaluar fazën e parë janë ftuar nga konsulenti të parashtrojnë ofertën e tyre teknike deri në datën 05.09.2017.

Në raportin paraprak të vlerësimit të ofertave teknike, të prezantuar nga Konsulenti dhe miratuar nga OST në Mars 2018, është ngritur pretendimi i verifikimit të saktësisë në kriteret para-kualifikuese për K... P... P... E... T... E... Inc si më poshtë:

-është kanstatuar se në dokumentacionin e dorëzuar prej tij ka mospërputhje të dhënash(datat) për përfundimin e projektit ÷Ndërtimi i N/st Zerjanevicë (viti 2007 apo viti 2005) dhe për këtë arsye është kërkuar plotësim dokumentacioni.

Për këtë arsye pas klarifikimeve, është kërkuar skualifikimi i këtij aplikanti.

Gjithashtu, në e-mail e saj, datë 26 Mars 2018 banka (Kf) ka sqaruar se:

E kemi të vështirë të pranojmë përfundimin e mësipërm për kompaninë K... me arsyetimin se:

1.Ofertuesi K... ka siguruar lidhur me kërkesat e saktësimi nr.02 dhe 03 evidenca justifikuese dhe dokumentare, gjë që na bën të vijnë në konkluzionin se Ofertuesi i plotëson kërkesat për dokumentet para-kualifikuese ;

2.Gjatë procedurës së tenderit vendimi duhet patjetër të jetë bazuar mbi evidencën dokumentare të prezantuar formalisht nga ofertuesi ose kur, n.q.se është e aplikueshme, nëpërmjet kërkesave sqaruese formale.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr.23 datë 08.03.2018, të Administratorit z. K...G...caktohet Kryetar i KVO z. K...S...

Më e-mail e Kf datë 11. Maj 2018 jepet dokordësia (No-Objection) e Raportit të Vlerësimit Final me shënimin ÷se ne nuk do të ndajmë plotësisht opinionin e punëdhënësit dhe konsulentit lidhur me mos përmbushjen e ofertës së prezantuar nga K... P... P... E...T...E... Inc në lidhje me kriterin e para-kualifikimit”.

Seksioni 2.7 i “Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere”-Gusht 2016, nuk është përjashtues në thelbin e tij, por lejon krahasimin e të gjithë ofertuesve për të përcaktuar avantazhet më të dobishme.

Sa sipër, në rastin e aplikantit K...nuk qëndron argumentimi se ekziston dyshimi për përmbushjen e kushteve minimale të parashikuara në fazën para-kualifikuese, për arsyen e thjeshtë se ky aplikant ka kaluar fazën e para-kualifikimit në mënyrë të pakushtëzuar.

Pra, edhe në këtë fazë të procesit të përzgjedhjes të kontraktorit janë vërejtur mangësi në ushtrim të detyrave funksionale nga ana e OST për koordinimin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit, të cilat kanë shkaktuar një deformim të procesit të vlerësimit.

Procedura ka vazhduar me fazën e hapjes të zarfave financiar për tre ofertuesit e tjerë A... S.p.A, E... E... e S..., C... G.. G... GmbH M... S.A më 16.05.2018 në S... ora 12:00. Kontrata për kryerjen e punimeve, është lidhur me operatorin òE... E... e S...S.Aò, në vlerën 19,277,703 Euro.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. K... G... ish-Administrator i OST, z. K... S... ish-Drejtor i Projekteve të Huaja në OST, znj. A... V... Përgjegjëse e Nj. Z. P.

Procedura për Lot-2 Linjat

Për procedurat e prokurimit të projektit òEficienca e Energjisë të Sektorit të Transmetimitò-ndërtimi i linjës transmetimit 220 kV Tiranë-Rrashbull dhe unaza 110 Kv e Tiranës, Ref. BMZ Nr.2011.66.388, me Urdhrin e Brendshëm Nr.53/3 Prot., datë 16.01.2017 është ngritur KVO e përbërë me Kryetar z. B...M... dhe anëtarë z. E...R..., z. G...D..., z. I... P..., znj. M... C...

Në fazën e parakualifikimit në datë 06.02.2017, ora 13:00 kanë marrë pjesë 5 ofertues sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Ofertuesit	Vendi
1.	C... I... 2000	Itali
2.	D...	Kroaci
3.	C... E.T.. N...A./E... M...	Suedi/Serbi
4.	E...d.d.	Bosnjë-Hercegovinë
5.	C... S../S...	Itali

Nga raporti vlerësimit të konsulentit datë 08.05.2017 kanë kaluar fazën e parakualifikimit dy kompani E... d.d.-S... dhe C... E... T...N... T... A.../E... M...a.d.

Në vazhdim të procesit të para-kualifikimit, ftesa për ofertë është dërguar në datën 17 Maj 2017 dhe afati i dorëzimit të ofertave është vendosur 01.08.2017. Në datën 28 Korrik 2017, për shkak kërkesave sqaruese dhe ri-caktimit të plan-vendosjes të n/stacionit Tirana 3, është lëshuar amendamenti Nr.01 për Dokumentet e Tenderit.

Sa sipër, afati për dorëzimin e ofertave është shtyrë më 5 Shtator 2017 në ora 9:30. Nga vlerësimi i detajuar teknik vetëm E...d.d. i kishte plotësuar kushtet teknike. Raporti final i vlerësimit të ofertës teknike, është dakordësuar nga Kf në datë 13 Shkurt 2018.

Njoftimi i E... për hapjen e ofertës financiare është dërguar më 23 Shkurt 2018.

Procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e kontraktorëve për Lot 2 janë kryer në përputhje me udhëzimet dhe manualët e Bankës.

Titulli i gjetjes: **Shkelje e procedurave të tenderit në procesin e prokurimit për shërbimin e konsulencës.**

Situata 1: Në proces-verbalin nr.4944 prot., datë 26.08.2015, ora 16:20, i mbajtur nga z. Y...D...Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit është deklaruar hapja gabimisht, nga ana e punonjësës së protokollit, e kutisë dhe e zarfit të ofertës ekonomike për ofertuesin M... D...-C...

Por, me e-mail e datës 26 Gusht 2015 ora 14:05 nga Njësia e Zbatimit të Projekteve (PIU) të OST është njoftuar agjenti i tenderit për mbërritjen e ofertave të aplikantëve F..., C...M... D...

dhe G... I... Në këtë mënyrë, kjo njësi duhej të kishte marrë masat për ruajtjen e tyre në gjendje të vulosur deri në momentin e hapjes në datën 28 Gusht 2015.

Hapja e ofertës sa më sipër është kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në pikën 2.3, paragrafi 2.12 të Udhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnereë, ku përcaktohet se: *Oferta e shërbimeve do të jetë hapur menjëherë pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Zarfet, që përmbajnë kuotimet e çmimeve do të mbahen të vulosur dhe do të jenë hapur vetëm me miratimin e KfW për ato ofertues, që kanë arritur të paktën 75 % të pikëve.*

Me shkresën Nr.5056 Prot. datë 1/09/2015, të Administratorit të OST z. E...Z...është njoftuar përfaqësuesi i KF (Banka për Evropën Juglindore dhe Turqinë) mbi ngjarjen e ndodhur sa më sipër, si edhe është kërkuar njëkohësisht anulimi i procedurës së tenderit për shërbimin e konsulentit.

Në aneksin 2 bashkëlidhur të Udhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnereë, pika 2, paragrafi përpara një anulimi të mundshëm të tenderit është parashikuar se: propozimi nga klienti që tenderi të anulohet duhet të jetë me arsyetim, si edhe duhet të ndjekë kriteret e këtij Udhëzuesi dhe duhet të shoqërohet me dokumentet përkatëse si kërkohet nga Kf .

Por, kërkesa për anulimin e tenderit nuk ka ardhur si shkak për asnjë nga rastet e parashikuara në paragrafin 2.6 në Udhëzimin për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnereë kur:

- a) nuk ka patur konkurrencë të mjaftueshme;
- b) asnjë nga ofertat nuk ka arritur minimumin e pikëve;
- c) Kanë ndryshuar aspekte teknike dhe financiare bazë përpara lidhjes së kontratës;
- d) Kuotimet e çmimit janë mjaft të dukshme të larta. Në këtë rast alternative është ose mbajtja e një procedure tenderi të re, ose nisje e negociatave mbi çmimin me ofertuesin i cili vjen i pari;

Sa sipër, për shkak të mangësive në menaxhimin e procedurave të tenderit ka dështuar procesi i vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, përsëritjai e procesit të tenderit për caktimin e konsulentit, për arsye subjektive ka sjellë vonesa të theksuara për rreth 1 vit për realizimin e procedurës së tenderit për shërbimin e konsulentit.

Kriteri :

Paragrafi 2.6 në Udhëzimin për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnereë të Kf -Shtator 2013, ku përcaktohet që:

anulimi i ftesës për tender mund të ndodhë kur:

- a) nuk ka patur konkurrencë të mjaftueshme;
- b) asnjë nga ofertat nuk ka arritur minimumin e pikëve;
- c) Kanë ndryshuar aspekte teknike dhe financiare bazë përpara lidhjes së kontratës;
- d) Kuotimet e çmimit janë mjaft të dukshme të larta. Në këtë rast alternative është ose mbajtja e një procedure tenderi të re, ose

nisje e negociatave mbi çmimin me ofertuesin i cili vjen i pari;
Paragrafi 2.12, pika 2.3, të Caktimit të Konsulentit ku përcaktohet që:

Oferta e shërbimeve do të jetë hapur menjëherë pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Zarfet, që përmbajnë kuotimet e çmimeve do të mbahen të vulosur dhe do të jenë hapur vetëm me miratimin e KfW për ato ofertues, që kanë arritur të paktën 75 % të pikëve.

Aneksi 2 në Udhëzimin për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere.

Ndikimi: Dështim i procesit të vlerësimit në tenderin e konsulencës
Shkaku: Të meta dhe mangësi në ndjekjen dhe koordinimin e procedurave të tenderit.
Rëndësia: E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.3985/4 prot., datë 28.07.2020 mbi Projekt Raportin e Auditimit nga znj. A...V..., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Udhëzimi i KfW për përzgjedhjen e konsulentit, pika 2.12 e tij, është boshti kryesor mbi të cilin u mbështetëm për anulimin e procedurës, pasi zarfi financiar ishte hapur para datës së caktuar për hapjen e tenderit. Pra duke qenë se zarfi financiar nuk kishte mbetur më i mbyllur dhe i vulosur siç përcaktohet në këtë pikë deri në miratimin e KfW pas marrjes së 75 % të pikëve në vlerësimin teknik, atëherë për mos të qenë në shkelje të saj (pikës 2.12 të Udhëzuesit) iu drejtuam KfW-së për anulimin e tenderit.

-Pika 2.6 e Udhëzuesit të mësipërm parashikon rastet përgjithësuese për anulimin e procedurës, ndërsa rasti konkret ka qenë mjaft specifik. Vetë KfW-hartuesja e këtij Udhëzimi nuk e ka referuar pikën 2.6 si kusht për anulim, por ka miratuar menjëherë anulimin në letrën e saj datë 02.10.2015 ku në paragrafin e dytë, banka shprehet: Kjo është një shkelje e procesit të vlerësimit dhe në kontradiktë me praktikën e një prokurimi të drejtë dhe transparent.

-Nuk ka asnjë vlerësim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pikërisht sepse vlerësimi nuk nisi fare.

-Agjenti i tenderit është personi i kontraktuar nga KfW për të vepruar në emër të saj, për të asistuar OST në procesin e përzgjedhjes së konsulentit, sikurse përcaktohet në pikën 1.10 të Udhëzuesit –Shtator 2013. Në rastin konkret, baka është shprehur drejtpërdrejt për anulimin e tenderit, duke konsideruar kështu të panevojshme përfshirjen e përfaqësuesit të saj në këtë çështje.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë si më poshtë:

Klienti i bankës, gjatë procesit të prokurimit për caktimin e konsulentit duhet të respektojë kushtet e përcaktuara në Udhëzuesin për Caktimin e Konsulentit. Çdo kërkesë lidhur me anulimin, në përputhje me këtë udhëzim duhet të respektojë kushtet e parashikuara në pikën 2.6.

Në pikën 1.2 Përgjegjësia për caktimin e Konsulentëve, paragrafi 1.05 përcaktohet se: Klienti me aprovimin e KfW, kur realizimi i procedurës është mbështetur nga një agjent tenderi, mund të delegojë pjesë të procedurës (përgatitjen e dokumenteve të tenderit, publikimin, vlerësimin e ofertave, negociata kontraktuale) ose dhe gjithë procesin.

Rasti konkret, ofertat origjinale kishin mbërritur përpara datës së dorëzimit edhe tek agjenti i tenderit I... C...&S., në adresën zyrtare të tij. Nga auditimi nuk rezulton që OST të ketë kërkuar një zgjidhje të tillë.

Gjithashtu, ashtu si edhe ju e keni pranuar, situata e gjetur gjatë auditimit, lidhur me procedurat për zgjedhjen e konsulentit, dhe konkretisht hapja e zarfit financiar në datën 26 Gusht 2015 bie në kundërshtim me pikën 2.3 Faza e tenderimit, paragrafi 2.12, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Titulli i gjetjes:	Deformim i procesit të vlerësimit të ofertave të kontraktorëve për Lot-1.
Situata 2:	<p>Në procesverbalin të mbajtur nga KVO nr.53/8 prot. datë 06.04.2017, kanë kaluar fazën e pare të para-kualifikimit si më poshtë:</p> <p>- K...P...Plant E... T... E... Inc. është kualifikuar pa kushte;</p> <p>-A... S.p.A, E...E... e S..., C... G... G... GmbH M... S.A me kushtin, që mangësitë respective të konstatuara do të rregullohen në fazën vijuese të tenderit.</p> <p>Në raportin paraprak të vlerësimit të ofertave teknike, të prezantuar nga Konsulenti dhe miratuar nga OST në Mars 2018, është ngritur pretendimi i verifikimit te saktësisë në kriteret para-kualifikuese për K... P... P... E... T... E... Inc si më poshtë:</p> <p>-është kanstatuar se në dokumentacionin e dorëzuar prej tij ka mospërputhje të dhënash(datat) për përfundimin e projektit ÷Ndërtimi i N/st Zerjanevicö (viti 2007 apo viti 2005) dhe për këtë arsye është kërkuar plotësim dokumentacioni.</p> <p>Për këtë arsye pas saktësimeve, është kërkuar skualifikimi i këtij aplikanti.</p> <p>Gjithashtu, në e-mail e saj, datë 26 Mars 2018 banka (Kf) ka sqaruar se:</p> <p>Më e-mail e Kf datë 11. Maj 2018 jepet dokordësia (No-Objection) e Raportit të Vlerësimit Final me shënimin ÷se ne nuk do të ndajmë plotësisht opinionin e punëdhënësit dhe konsulentit lidhur me mospërmbushjen e ofertës së prezantuar nga K... P... P... E... T... E... Inc në lidhje me kriterin e para-kualifikimit”.</p> <p>Seksioni 2.7 i “Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere”-Gusht 2016, nuk është përjashtues në thelbin e tij, por lejon krahasimin e të gjithë ofertuesve për të përcaktuar avantazhet më të dobishme.</p> <p>Pra, sa sipër në rastin e aplikantit K...nuk qëndron argumentimi se ekziston dyshimi për përmbushjen e kushteve minimale të parashikuara në fazën para-kualifikuese, për arsyen e thjeshtë se ky aplikant ka kaluar fazën e para-kualifikimit në mënyrë të pakushtëzuar.</p> <p>Pra, edhe në këtë faze të procesit të përzgjedhjes të kontraktorit janë vërejtur mangësi në ushtrim të detyrave funksionale nga ana e OST për koordinimin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit.</p>
Kriteri :	Seksioni 2.7, paragrafi 2.27 Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere-Gusht 2016.
Ndikimi:	Deformim i procesit të vlerësimit.
Shkaku:	Të meta dhe mangësi në procesin e koordinimit dhe ndjekjes të vlerësimit të ofertave.
Rëndësia:	E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.3985/4 prot., datë 28.07.2020 òMbi Projekt raportin e Auditimit nga znj. A...V..., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Kemi paraqitur si provë praktikën shkresore nga kërkesa për klarifikim dërguar ofertuesit K... lidhur me një dokument të paraqitur prej tij që në fazën e para-kualifikimit për të cilin kishin lindur dyshime (bazuar në pikën 2.7 të Udhëzuesit “Për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere” – Gusht 2016, paragrafi 2.27) e deri në shkresën e KfW datë 23.04.2018 (hyrje në OST nr.2971 datë 24.04.2018.)

-Raporti i Vlerësimit për të cilin është dhënë miratimi(No-Objection) i KfW me e-mail e datës 11 Maj 2018, u përfundua vetëm pas ardhjes së shkresës KfW datë 23.04.2018, ku banka shprehet se nuk ka kundërshtim lidhur me propozimin e OST për të përjashtuar ofertuesin K...nga vazhdimi i procedurës për Lot 1.

Pra përjashtimi i këtij ofertuesi nga gara, si pasqyrohet në Raportin përfundimtar të Vlerësimit Teknik dhe procesverbalin e KVO Nr, 297/1 Prot., datë 24.04.2018, është bërë vetëm pas marrjes së shkresës së mësipërme nga banka, ku ajo shpreh moskundërshtimin e saj për këtë përjashtim.

-Procesverbali Nr.53/8 Prot., datë 06.04.2017 I KVO është mbajtur pas paraqitjes nga konsulenti i Raportit të Vlerësimit për Para-kualifikimin dhe shpreh dakordësinë e komisionit për këtë raport. Në këtë procesverbal evidentohet kualifikimi i K...dhe kualifikimi me kusht i tre ofertueseve të tjerë.

Gjatë fazës së vlerësimit teknik ka lindur dyshimi për një dokument që vërtetonte eksperiencën e mëparshme teknike të K...dokument ky i prezantuar që në fazën e para-kualifikimit. Në këto kushte si e kemi përmendur, bazuar në pikën 2.27/2.7 të Udhëzuesit “Për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere” – Gusht 2016, konsulenti është drejtuar K... për saktësimin e këtij dyshimi të lindur.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë si më poshtë:

- Në pikën 2.27, paragrafi i fundit në seksionin 2.7 të Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere-Gusht 2016 përcaktohet se: Në qoftë se vlerësimi ishte paraprirë nga faza para kualifikuese, kriteret që janë konsideruar tashmë mund të mos jenë shqyrtuar përsëri përveç dyshimeve, që janë shfaqur në lidhje me përmbushjen e kriterëve minimale kualifikuese.

Konsulenti në krahasim me paragrafin 2.27 të udhëzuesit ka gabuar në pretendimin e tij lidhur me rishikimin e njërit prej kushteve minimale, atij të eksperiencës Ky paragraf ka të bëjë me dyshimin e përmbushjes së kriterëve minimale në tërësinë e tyre dhe se kur është dyshimi i mos përmbushjes minimalisht, mund të kërkohet më tutje një dokument tjetër apo mbështetës. Nga ana tjetër, ashtu si edhe ju vetë e pranoni, në procesin e vlerësimit në fazën para kualifikuese ky aplikant e ka kaluar provën e këtij dokumenti në mënyrë të qartë dhe pa kushte. Rikthimi te ky dokument është i pakuptimtë. Këtë gjë e vërteton edhe kundërshtimi i ish Kryetarit të KVO z. L... K... si edhe pranimi me rezervë i KfW në 11. Maj 2018.

- Seksioni 2.7 i òUdhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere-ò-Gusht 2016, nuk është përjashtues në thelbin e tij, por lejon krahasimin e të gjithë ofertuesve për të përcaktuar avantazhet më të dobishme.

- Në e-mail e KfW datë 11. Maj 2018 është dhënë dokordësia e raportit të vlerësimit me shënimin se KfW nuk ka ndarë plotësisht opinionin e punëdhënësit dhe konsulentit lidhur me mos përmbushjen e ofertës së prezantuar nga K... P... P...E... T... E... Inc në lidhje me kriterin e prekalifikimit.

- Procesverbali i mbajtur nga KVO mbi vlerësimin e dokumenteve para kualifikuese nr.53/8 prot. datë 06.04.2017 sqaron se nga 9 kompanitë ofertuese kualifikohet për fazën tjetër K... P... P... E...T... E... Inc. Pa kushte, dhe se A... S.p.A, E... E... e S..., C... G... G... GmbH M... S.A do të kualifikohen me kushtin, që mangësitë respektive të konstatuara do të rregullohen në dokumentet e ofertës që do të paraqiten në fazën vijuese të tenderit.

Pra, përjashtimi nga gara e aplikantit K... P... P... E... T... E... Inc bie në kundërshtim me pikën 2.27, paragrafi i fundit në seksionin 2.7 të Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere-Gusht 2016 prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

E. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe shërbimeve

Për realizimin e procedurave të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë :

- Marrëveshja e Veçantë;
- Kontrata e Shërbimit të Konsulencës;
- Amendimi i Kontratës së Konsulencës;
- Praktikat e paraqitura për kryerjen e shërbimeve;
- Korrespondenca dhe kërkesa me bankën (Kf) etj.

Kontrata e Shërbimit të Konsulencës, Nr.5227 prot., datë 13.09.2016 òPër shërbimet e konsulentitò në vlerën 2,458,615 þ është nënshkruar ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), dhe F...GmbH & Co.K.. S..., G... Shërbimet e konsulencës janë kryer për linjën ajrore me dy qarqe 220 kV Tirana - Rrashbull dhe unaza 110 kV e Tiranës. Shërbimet e konsulentit janë ndarë në dy faza A dhe B.

Faza A mbulon projektin e hollësishëm dhe asistencën për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë rishikimin e konceptit të projektit apo dhënien e konsideratave për planet e zhvillimit si edhe studimi i fizibilitetit për implementimin (përgatitja e specifikimeve të hollësishme teknike, përgatitja e vizatimeve të domosdoshme, dokumentet e tenderit etj.) Gjithashtu, qasjen për implementimin e linjës së transmetimit si një linjë e vetme ose me dy qarqe 400 kV në vend të linjës 220 kV me qëllim që të integrojë në të ardhmen unazën 400 kV në Shqipëri.

Faza B mbulon mbikëqyrjen e projektit, ndërtimin dhe ekzekutimin e kontratave, duke përfshirë progres raportet 3/mujore dhe përmbledhje të shkurtër mujore për kontraktorët kryesor.

Ekzekutimi i kontratës ka filluar dy javë pas nënshkrimit të saj më 05.09.2016. Kjo është përcaktuar në paragrafin Ad.1.1 òkushtet specialeò, pjesë e kësaj kontrate.

Referuar pikës Ad 3.4 te òkushtet specialeò të kontratës, janë përcaktuar afatet kur konsulenti duhet të raportojë mbi progresin e shërbimeve që ka kryer, si më poshtë:

Nr.	Reporti /Dokument	Koha e dorëzimit	Data e dorëzimit
1	Raporti Fillestar	8javë pas datës së fillimit	11/11/2016
2	Raporti mbi ambjentin ESIA	8 javë pas datës së fillimit	11/11/2016
3	Kushtet e kontratës-draft	12 javë pas datës së fillimit	9/12/2016
4	Raporti i planifikimit dhe projektit të hollësishëm	12 javë pas datës së fillimit	9/12/2016
5	Dokumentat e (Draft) Tender	14 javë pas datës së fillimit	23/12/2016
6	Dokumentat e Tenderit (Final)	16 javë pas datës së fillimit	6/1/2017
7	Raporti i Vlerësimit të Tenderit6/1/2017	4 javë pas hapjes së ofertës	Janar-Dhjetor 2019, Janar- Mars 2020
8	Progres Raporti 3/mujor (faza B)	Çdo 3 /muaj	
9	Raporte Mujore (Faza A	Mujor	
10	Final Raport	Brenda 4 javësh pas përfundimit të projektit	

Referuar pikes Ad 5.2 **Kushtet e pagesës**, te ÷kushtet specialeo të kontratës është përcaktuar se pagesat e konsulentit do të kryhen përkundrejt prezantimit të faturave për çdo instalment (Lump sum) të parashikuar në kontratë.

Me Amendamentin Nr.01, Nr.1985/1 prot. datë 24.03.2017 të kontratës bazë të konsulentit, është dakordësuar kërkesa e F... GmbH & Co.K... datë 21.03.2017 për mënyrën e disbursimit nga parashikimi për punimet shtesë, që do të kryhen nga kontraktorët në N/stacionet e Farkës, Selitës, Tirana 1 dhe Uzina Traktori, me qëllim integrimin e tyre në unazën 110 kV të Tiranës dhe integrimi i këtyre lidhjeve në sistemet ekzistuese të mbrojtjes, SCMS, telekomunikimit dhe matjes. Sa sipër, vlera e kontratës rritet si më poshtë:

Faza A: Nga 618,615.00 þ u bë 654,670.00 þ.

Faza B: Nga 1,513,355.00 þ u bë 1,803,945.00 þ.

Nëpërmjet faturave D17/1327 dhe D17/1328 datë 24.04.2017 F... GmbH & Co.K..., sipas kushteve të pikës Ad 5.2 të kontratës, është kërkuar pagesa prej **371,169.00 €** ose 60 % nga fondi i fazës A prej 618,615.00 þ, si edhe pagesa prej **27,041.25 €** ose 75 % të shtesës nga amendamenti nr.01 i kontratës nr.1585/1 prot., datë 24.03.2017, prej 36,055 þ për fazën A. Raportimi i shërbimeve të konsulentit, për fazën A, është kryer si më poshtë:

-raporti mbi mjedisin (ESIA Report) është dorëzuar nr.1210 prot, datë 03.03.2017 me një vonesë prej 11 javësh,

-raporti i hollësishëm i projektimit dhe planifikimit (Detailed Planning and Design Report) është dorëzuar nr. 2301 prot. datë 26.04.2017, me një vonesë prej 19 javësh.

Si përfundim, bazuar në faturën D17/1327 datë 24.04.2017 për vlerën e paguar në shumën 371,169 þ, si edhe në datat e dorëzimit të raportit fillestar (Inception Report), ESIA Report, dhe raportit të projektimit dhe planifikimit të hollësishëm (Detailed Planning and Design Report) është krijuar periudha e vonesës nga data 11.11.2016 deri në datë 26.04.2017 ose 21 javë. Referuar paragrafit 4.2 Penalitete për vonesën në kontratën e konsulentit, njësia duhej të llogariste penalitete në 38,973þ. ose 4,745,742.21 lekë ngarkim të F... GmbH & Co.K...

Aplikimi në vlerën totale 270,591,75 þ, e cila rezulton e paguar në datën 27.03.2019, lidhet me fillimin e fazës B, supervizionin e kontratave të zbatimit dhe komisionimin dhe përbën paradhenien e kësaj faze.

Gjatë kësaj faze konsulenti merr rolin e inxhinierit në lidhje me kushtet e kontratës për projektimin dhe ndërtimin e veprës.

Dy kontratat e implementimit për punime civile janë firmosur përkatësisht në datat 14.11.2018 dhe 27.12.2018, dhe i janë vënë në dispozicion Kf -së kopjet e plota të kontratës me datë 08.02.2019 duke shënuar përfundimin dhe pranimin e fazës A për shërbimin e konsulencës.

Sa sipër, vihet re një neglizhencë e strukturave përgjegjëse të OST lidhur me respektimin e kërkesave të kontratës nga ana e konsulentit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. J... K... ish - financiere e Nj. Z. P., zj. A...V...Përgjegjëse e Nj. Z. P T.

Titulli i gjetjes: **Penalitete të pa mbajtura, gjatë zbatimit të kontratës së Konsulentit.**

Situata 2: Me anën e faturave D17/1327 dhe D17/1328 datë 24.04.2017, është kërkuar nga F... GmbH & Co.K... pagesa prej **371,169.00 €** ose 60 % nga fondi i fazës A prej 618,615.00 þ, si edhe pagesa prej **27,041.25 €** ose 75 % të shtesës nga amendamenti nr.01 i kontratës nr.1585/1 prot., datë 24.03.2017, prej 36,055 þ për fazën A.

Raporti mbi mjedisin (ESIA Report) është dorëzuar nr.1210 prot. datë 03.03.2017 me një vonesë prej 11 javësh;

Raporti i Detajuar i Projektimit dhe Planifikimit (Detailed Planning and Design Report) është dorëzuar nr. 2301 prot. datë 26.04.2017, me një vonesë prej 19 javësh.

Referuar pikës Ad 3.4 të kushtet speciale të kontratës, janë përcaktuar afatet kur konsulenti duhet të raportojë mbi progresin e shërbimeve që ka kryer, si më poshtë:

-Raporti i Fillestar 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;
-Raporti mbi ambientin ESIA 8 javë pas hyrjes në fuqi ose 11.11.2016;

-Raporti i Planifikimit dhe Projektimit të Detajuar 12 javë pas hyrjes në fuqi ose 09.12.2016.

Veprimet për dorëzimin e shërbimeve të kryera nga konsulenti bien në kundërshtim me kushtet speciale paragrafin Ad.3.4 të kontratës së konsulentit.

Për këtë arsye:

Referuar paragrafit 4.2 Penalitete për Vonesën në kontratën e konsulentit, si edhe periudhës së vonesës nga data 11.11.2016 deri në datë 26.04.2017 ose 21 javë, njësia duhej të llogariste penalitete në shumën 38,973 p ose 4,745,742.21 lekë në ngarkim të konsulentit.

Kriteri :

Paragrafi Ad.3.4, Kushtet Speciale të kontratës së Konsulentit, (afatet e dorëzimit) ku përcaktohet programi i parashikuar i shërbimeve sim ë poshtë:

-Raporti i Fillestar 8 javë pas fillimit të projektit;
-Raporti mbi ambientin ESIA 8 javë pas fillimit të projektit;
-Raporti i Planifikimit dhe Projektimit të Detajuar 12 javë pas fillimit të projektit;

Paragrafi 4, pika 4.2 nën paragrafi 4.2.1 ku përcaktohet që:

Në qoftë se Konsulenti dështon të kryejë shërbimet sipas kontratës brenda kohës së kërkuar, dhe për arsye që ai ka garantuar, pavarësisht kushteve speciale Punëdhënësi do të përfshijë një zbritje ,që e autorizon të sjellë një gjobë 0.5 % të vlerës së shërbimit të porositur, për çdo javë vonesë.

Ndikimi:

Nuk aplikohen penalitetet nga kontrata e konsulentit.

Shkaku:

Neglizhenca e strukturave përgjegjëse të OST.

Rëndësia:

E lartë

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.3985/2 prot., datë 28.07.2020 mbi Projektraportin e Auditimit nga znj. A...V..., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Ju sqarohet se Raporti i Hollësishëm i Projektimit dhe Planifikimit fillestar është paraqitur nga Konsulenti me e-mailin e datës 20.01.2017.

Ndërsa versioni përfundimtar i këtij raporti është finalizuar në datën 20.04.2017, datë në të cilën është bërë miratimi nga ana e KfW-së.

Në datë 24.04.2017, pra pas marrjes së No-Objection nga Banka, është paraqitur nga Konsulenti raporti përfundimtar në formë elektronike.

Në datë 26.04.2017 është dorëzuar në protokollin e OST nga Konsulenti Raporti së bashku me faturën përkatëse.

Pra siç shihet, Raporti i Hollësishëm i Projektimit dhe Planifikimit përfundimtar dhe fatura janë paraqitur/dorëzuar në të njëjtën kohë në OST nga Konsulenti, pra të dyja në datë 26.04.2017.

Aplikimi jonë për pagesë për këtë raport, drejtuar KfW në datë 14.07.2017, është bërë në respektim të kushteve për pagesë të parashikuara në Ad. 5.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës së konsulencës:

-Paraqitja e faturës (60% të vlerës së kontratës për të tre raportet) datë 24.04.2017, hyrje në protokollin e OST Nr.2300 Prot. . datë 26.04.2017.

-Paraqitja e raportit të pranuar nga KfW nëpërmjet No-Objection përkatës datë 20.04.2017. Për Detailed Planning and Design Report hapësira kohore nga data 20.01.2017 kur është paraqitur raporti fillestar e deri në datën 24.04.2017 kur është paraqitur raporti përfundimtar ka ardhur si pasojë e shkëmbimit të vazhdueshëm të komenteve Konsulent-OST-KfW si edhe e disa aktiviteteve të lidhura me shërbimet e konsulencës të nevojshme për këtë projekt si Studimi i shkurtër linjës ajrore Tirana 2 - Rrashbull, survejimi i gjurmëve paraprake të linjave, vendimi për aplikimin e librit të FIDIC (Federata Ndërkombëtare E Inxhinierëve Konsulentë) dhe aktivizimi i opsionit 1 nëpërmjet Amendimit Nr.1 të kontratës së konsulencës. Pra, kjo hapësirë kohore nuk është shkaktuar për vonesë të konsulentit, ndaj nuk kemi qenë në kushtet për aplikimin e penalitetit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Prezantimi në të njëjtën kohë, i faturave dhe raporteve nuk ka penguar ligjërisht procesin e disbursimit dhe pagesën e konsulentit, por mungesa e respektimit të afateve të përcaktuara në nën-paragrafin Ad. 3.4, për dorëzimin e raporteve, në kushtet kur këto afate nuk janë të amenduara ka ngarkuar me përgjegjësi konsulentin, i cili duhet ti nënshtrohet penalitetit, siç parashikohet në nën-paragrafin 4.2- Penalitetet, në kontratën e konsulentit.

-Amendimi Nr.1, Nr.1585/1 Prot., datë 24.03.2017 i Kontratës për Shërbimet e Konsulencës, është kryer për të përcaktuar vetëm mënyrën e disbursimit të fondit shtesë të parashikuar për fazën A 36,055.00 EUR dhe për fazën B 290,590.00 EUR.

Në paragrafin 4 të Amendimit Nr.1, Nr.1585/1 Prot., datë 24.03.2017, është treguar se koha e programimit për projektin (koha e kryerjes të shërbimeve të konsulentit) mbetet e pandryshuar. Shprehja ÷Faza A pritët të shtyhet për një periudhë prej afërsisht 2 muajë, përcakton mundësinë të një shtyerje, e cila duhet të argumentohet në te ardhmen.

E njëjta gjë thuhet edhe në relacionin e Drejtorit të Departamentit Teknik të OST nr.1585 prot. datë 21.03.2017, drejtuar Administratorit të OST z. E... Z..., ku thuhet se: ÷Megjithatë, Faza A, pritët të shtyhet me një periudhë prej dy muaj. (Nëse rezulton fisibël një shtyerje e tillë, do të finalizohet përkatësisht me amendim kontraktual.)÷

-Në relacionin me nr. 708 prot., datë 11.11.2016 të Drejtorit të DPZK të OST, drejtuar Këshillit Teknik, është propozuar shqyrtimi i studimit të konsulentit për ndërtimin e linjës Tirana 2 ó Rrashbull ÷Short System Study for Tirana - Rrashbull Transmission Line rev. 07.11.2016÷, ku parashikohen dy versione të tjera të mundshme për ndërtimin e kësaj linje.

Gjithashtu, në proces-verbalin nr.7096 prot., datë 14.11.2016 të Këshillit Teknik me Kryetar z. E...Z... Administrator i OST, është vendosur që të realizohet ndërtimi i linjës Tirana 2 ó Rrashbull me dy qarqe me bazamente dhe shtylla për tension 400 kV dhe me përcjellës me tension 220 kV, si variant 1 i parashikuar nga studimi i mësipërm.

Pra, meqenëse shërbimet e konsulentit lidhur me dorëzimet e Raporti mbi mjedisin (ESIA Report) dorëzuar nr.1210 prot. datë 03.03.2017 dhe Raporti i Detajuar i Projektimit dhe Planifikimit (Detailed Planning and Design Report), dorëzuar nr. 2301 prot. datë 26.04.2017 bien në kundërshtim me Ad. 3.4, Kushtet Speciale për dorëzimin e raporteve, në kontratën e konsulentit, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

E1. Mbi ecurinë e realizimit të kontratave të lidhura nga OST në lidhje me Projektin: “Efiçenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”

Mbi bazën e Akt verifikimit të mbajtur më datë **23.12.2021**, të kryer pranë OST, lidhur me ecurinë e mëtejshme të realizimit të kontratave të lidhura nga OST për zbatimin e Projektit: ÷Efiçenca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike÷, si dhe mbi realizimin e objektivave sipas komponentëve të këtij projekti. Mision auditimi i ushtruar në

zbatim të autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditim dhe plotësim të evidencës së auditimit me nr.281/4 Prot., datë 14.12.2021.

Nga auditimi i ushtruar, mbi bazën e autorizimit të sipërcituar, e në vazhdim të misionit auditues të realizuar në OST në bazë të Programit të Auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 281/1 Prot., datë 30.04.2020 rezultoi si më poshtë:

- Projekti "Efiçenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", financohet nga Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) në formën e Huas, me një kosto totale të parashikuar në vlerën 40 milionë Euro. Huaja rregullohet nga ligji nr. 88/2015 datë 30.07.2015, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane KfW për Projektin "Efiçenca energjetike programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike".

Sipas marrëveshjes objektivi kryesor i projektit është: *Rritja e efiçencës së transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet shtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të nënstacioneve elektrike dhe linjave të transmetimit të tensionit të lartë, për të minimizuar humbjet teknike dhe për siguruar vazhdimësinë pa ndërprerje të transmetimit të energjisë elektrike.*

Në Marrëveshjen e veçantë të Huas së datës 02.07.2015, në aneksin 2 të saj, është përcaktuar skeduli kohor i realizimit të projektit ku është parashikuar të zbatohet përgjatë periudhës kohore, viteve 2015 - 2018. Më konkretisht sipas komponentëve sipas fazave të mëposhtme: Për komponentin I0 faza e zbatimit është përcaktuar të përfundoj deri në fund të vitit 2017. Për komponentin II0 faza e zbatimi është përcaktuar të përfundoj deri në fund të vitit 2018. *(Ndarja e Komponentëve të kësaj marrëveshje nuk janë korendues me Lotet e cituara më poshtë pasi elementë të komponentëve gjenden të integruara në sejcilin Lot sipas natyrës dhe rastit përkatës).*

Për "Lotin 1" të këtij projekti nga Autoriteti Kontraktor (OST) në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur, Kontrata me nr. 1857 prot. datë më 14.11.2018 me kompaninë E... në vlerën 19,277,703 Euro. Kjo kontratë është e tipit me ofelësa në dorë, me termin CIP site (vend). Kontrata parashikon afat zbatimi për Seksionin 1 prej, 24 muaj dhe për Seksionin 2 parashikon afatin e zbatimit prej 36 muaj. Këto afate fillojnë nga data e bërjes efektive të kontratës. Data e bërjes efektive të kontratës për këtë lot (Loti 1) rezulton të jetë data 28.03.2019.

Përsa i përket LOTIT 1 (Nënstacionet), parashikohen me dy seksione (Seksioni1 dhe Seksioni 2), si më poshtë:

Seksioni 1:

-Zgjerimi i Nënstacionit 220/110 kV Rrashbull" brenda sheshit ekzistues te këtij nënstacioni.

-Zgjerimi i Nënstacionit 400/220/110kV Tirana 2" brenda sheshit ekzistues te këtij nënstacioni.

Seksioni 2:

-Ndërtimi i N/S – it të ri Tirana 3- 400/110/20kV si edhe përforcimi i N/S-ve Tirana 1, Traktori dhe Selita.

Për "Lotin 2" të këtij projekti, nga Autoriteti Kontraktor (OST) në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur, Kontrata me nr. 8795 prot. më datë 27.12.2018 me kompaninë E...ö, në vlerën 18,405,408.³⁶ Euro. Kjo kontratë është e tipit me ofelësa në dorë, me termin CIP site (vend). Kontrata parashikon afat zbatimi për Seksionin 1 prej 24 muaj dhe për Seksionin 2 parashikon afatin e zbatimit prej 36 muaj. Këto afate fillojnë nga data e bërjes efektive të kontratës. Data e bërjes efektive të kontratës për këtë lot (Loti 2) rezulton të jetë data 06.05.2019.

Përsa i përket LOTIT 2 (Linjat), parashikohen me dy seksione (Seksioni1 dhe Seksioni 2), si më poshtë:

Seksioni 1:

-Ndërtimi i një linje të re transmetimi me dy qarqe 400/220kV Tirana 2 – Rrashbull dhe dy daljeve të reja 220kV, përkatësisht në N/Stacionet Tirana 2 dhe Rrashbull.

Seksioni 2:

-Ndërtimi i unazës 110kV: Tirana 1 – Traktori linjë kabllore 110kV, Tirana 3 – Traktori, linja 110kV pjesërisht ajrore dhe pjesërisht kabllore, Tirana 3 – Selita, linja 110kV pjesërisht ajrore dhe pjesërisht kabllore.

Nga auditimi mbi ecurinë, e mëtejshme, të zbatimit të këtyre kontratave sipas Loteve dhe Seksioneve të përfshira në to, rezulton si më poshtë:

Për Lotin 1:

Seksioni 1. Afati i përfundimit të kontratës është përcaktuar data 28.03.2021. Për këtë seksion nuk ka amendim të afatit të zbatimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Seksioni 2. Afati i përfundimit është shtyrë nëpërmjet amendamentit nr.1, datë 03.09.2020 deri më datë 28.05.2022.

Përsa i përket zbatimit të kontratës nr. 1857prot., datë më 14.11.2018 (për Lotin 1) nuk ka filluar zbatimi i saj.

Për Lotin 2:

Në lidhje me këtë kontratë për këtë Lot (për të dy Seksionet) janë realizuar dy amendamente si më poshtë:

Amendamenti nr. 3, datë 25.01.2021, që ka të bëjë me rialokimin e zërave të tipeve të testeve në Price Schedulin përkatës.

Amendamentit nr. 4, datë 25.02.2021 është bërë shtyrja e afatit të kontratës me 75 ditë për lotin 2 dhe reduktimin e çmimit të kontratës në 18,320,418.36 Euro.

Ndërsa për **Seksionin 2 të këtij Loti,** afati i përfundimit të kontratës është amenduar nëpërmjet **amendamentit nr. 2,** datë 15.10.2020. Në këtë amendament është parashikuar zgjatje afati prej 35 ditësh dhe kosto shtesë prej 5000 Euro, për shkak të ndryshimit të projektit.

Përsa i përket zbatimit të kontratës nr.8795 prot. datë 27.12.2018 (për Lotin 2) nuk ka filluar zbatimi i saj.

Në lidhje me Aktverifikimin nr. 1, datë 23.12.2021 mbajtur nga Grupi i Auditimit të KLSH, protokolluar në OST me nr.7256/, datë 23.12.2021, subjekti i audituar ka paraqitur sqarime në lidhje me mos realizimin e kontratave të sipërcituar nëpërmjet shkresës nr. 7256/3 Prot., datë 29.12.2021 dhe administruar në KLSH me nr.548/15prot., datë 29.12.2021, të cilat janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimet e marrëveshjes, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve u konstatua se, janë realizuar amendime të shumta të marrëveshjes së huas së datës 30.06.2015, në mënyrë të përmbledhur ato janë sa më poshtë:

-Amendimi i marrëveshjes së huas për riskedulimin e pagesave

Administratori i OST me shkresën nr. 2728Prot., datë 13.04.2018, ka paraqitur kërkesën pranë Kf për rishikimin e termave të huas, mbi rishqyrtimin e afatit të disbursimeve dhe skedulit të pagesave të huas. Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme, ka miratuar ndryshimet e kërkuara nga administratori i OST për ndryshimet e marrëveshjes së huas.

-Amendimi i marrëveshjes së huas për zgjatjen e afatit të disbursimit të huas.

Administratori i OST ka kërkuar përsëri shtyrjen e afatit të disbursimit deri më datë 30.12.2022 nga Kf , por Kf zgjatjen e afatit të disbursimit të huas, e kishte kushtëzuar, me detyrimin e OST për kryerjen e pagesës në shumën 861,206 euro si tarifë kompensimi.

Pas përfundimit të negociatave të OST me Kf , tarifa e kompensimit është përcaktuar në vlerën 377,519 euro, e cila është paguar nga buxheti i OST, çka përbën kosto shtesë për këtë projekt.

Amendimi i marrëveshjes së datës 27.09.2019, ka shtyrë, afatin e disbursimit deri më datë 31.12.2022. Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar me vendimin nr. 80, datë 16.09.2019, amendimin e marrëveshjes për shtyrjen e afatit të disbursimit. Vlera e penaltetit të vendosur për shkak të shtyrjes së afatit të disbursimit nuk është argumentuar nga ana e Kf , por edhe administratori e Këshilli Mbikëqyrës i OST, nuk kanë kërkuar shpjegime mbi mënyrën e llogaritjes së penaltetit në vlerë 861,206 euro nga Kf .

Amendimi i aneksit 6 të marrëveshjes së veçantë.

Marrëveshja e veçantë është amenduar pas miratimit dhe dhënies së autorizimit për miratimin e saj nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 12, datë 14.04.2017 dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me nr. 4160/1prot., datë 5.05.2017. Në këtë amendim është ndryshuar aneksi 6 (gjashtë), ku janë përfshirë komponentët kryesorë të projektit dhe kërkesat për procedurën e tenderit për konsulencën e kontraktorët (*Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 10-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve të Huaja, në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve të bëjnë parashikime të sakta për kostot e financimit dhe afatet e realizimit të projektit mbi bazën e studimit të fizibilitetit apo rishikimit të komponentëve të projektit në Këshillin Teknik, dhe pasi ti miratojnë në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, të pasqyrohen në marrëveshjet e huas.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndryshimin e komponentit II të marrëveshjes së huas, u konstatua se, Këshilli Teknik i OST në mbledhjen e datës 14.11.2016, shqyrtoi dy opsione të paraqitura nga konsulenti i projektit “F...”, si më poshtë:

Opsioni i parë: Lidhet me kërkesën e konsulentit për ndryshimin e linjave të hyrjes në nënstacionet 110kV nga linja ajrore (OHL) në linja kabllore për komponentin II të përcaktuar në marrëveshjen e huas, me objekt: ÷Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110kV: Tirana 1-Traktori-Tirana 3, Tirana 3-Selite dhe Tirana 3-Farkëo.

Opsioni i dytë: Paraqet kërkesën e konsulentit, mbi nevojën e realizimit të një studimi të plotë për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110kV të rajonit të Tiranës (ku përfshihen të gjitha nënstacionet dhe linjat në këtë projekt). Anëtarët e Këshillit Teknik kanë shprehur

dakordësinë, kryesisht për kërkesën e konsulentit për opsionin e dytë, duke marrë vendimin: *“Të negociohen të dy opsionet dhe ti hapet rrugë konsulentit për realizimin e një studimi të koordinimit të mbrojtjes rele për një pjesë sa më të gjerë të sistemit të transmetimit (opsioni i dytë)”*.

Pra, anëtarët e Këshillit Teknik kanë miratuar kërkesën e konsulentit për kryerjen e një studimi të plotë, për koordinimin e mbrojtjes rele për rrjetin 110 kV të rajonit të Tiranës, e cila sipas tyre, do të shërbejë qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në afat gjatë. Pavarësisht vendimit të Këshillit Teknik nr. 7096prot., datë 14.11.2016, OST bëri amendimin e kontratës së konsulentit me nr. 1585/1prot., datë 24.03.2017, duke pasqyruar vetëm opsionin e parë të propozuar nga konsulenti. Ndërkohë që në marrëveshjen e huas komponenti II ÷Ndërtimi/fuqizimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV: Tirana 1-Traktori-Tirana 3, Tirana 3-Selitë dhe Tirana 3-Farkëo është parashikuar që hyrjet në këto nënstacione të jenë linja ajrore. Në dokumentet e tenderit për termat e referencës (ToR) të përgatitura nga Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me OST dhe të dakordësuara nga Kf , për komponentin II, hyrja në nënstacionet 110kV është përcaktuar me linjë ajrore. Amendimi i kontratës së konsulentit, si rrjedhim i ndryshimit të konfigurimit të komponentit të dytë të parashikuar në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015 dhe në studimin e fizibilitetit të këtij projekti ***rriti kostot e shërbimit të konsulencës me 326,645 euro mbi vlerën e kontratës fillestare***, ku vlera totale e kontratës së konsulentit pas amendimit arrin në shumën 2,458,615 euro, ndërsa krahasuar me vlerën e konsulentit të planifikuar në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015 është rritur në shumën 208,615 euro (*Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 10-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve të Huaja, gjatë fazës së hartimit të termave të referencës për tenderin e shërbimit të konsulencës së projekteve duhet të bashkëpunojë me Këshillin Teknik të OST, për të analizuar dhe reflektuar ndryshime të mundshme, të komponentëve të projektit të përcaktuara në marrëveshjen e huas.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ndryshimit të ÷Komponentit I÷ të marrëveshjes së huas, u konstatua se, në marrëveshjen e huas objekti për ÷komponentin I÷ është: ÷Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220kV Tirana2 - Rrashbull dhe unaza 110kV e Tiranës. Sipas përcaktimit të marrëveshjes, ndërtimi i linjës Tirana 2-Rrashbull me dy qarqe duhet të realizohet, me bazamente, shtylla të tensionit të lartë, izolatorë dhe përcjellës me tension 220kV. Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 14.11.2016 ka marrë në shqyrtim studimin e shkurtuar për opsionet e ndërtimit të linjës Tirana 2-Rrashbull, hartuar nga konsulenti F... Në përfundim Këshilli Teknik ka marrë vendim që ndërtimi i linjës Tirana 2 - Rrashbull me dy qarqe, të realizohet me bazamente dhe shtylla për tensionin 400kV dhe me përcjellës me tension 200kV. Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 12.11.2018 ka marrë në shqyrtim vlerësimin e 2 (dy) konfigurimeve për ndërtimin e linjës 220kV me dy qarqe Tirana 2-Rrashbull, të cilat paraqiten si më poshtë:

Konfigurimi A parashikon që ndërtimi i linjës Tirana 2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me: *“Bazament dhe shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, por me izolator dhe përcjellës për tension 220kV”*. Pra ndryshe nga parashikimi i komponentit I, në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, ÷Konfigurimi A÷ ndryshon shtyllat e tensionit të lartë nga 220kV në 400kV. *Konfigurimi B*, parashikon që ndërtimi i linjës Tirana 2-Rrashbull me dy qarqe, të bëhet me:

“Shtylla të tensionit të lartë për tension 400kV, ku njëri qark të ketë izolator dhe përcjellës për tension 400kV, kurse qarku tjetër të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220kV”.

Pra, ndryshe nga parashikimi i ÷komponentit I÷, në marrëveshjen e huas së datës 30.06.2015, me ÷Konfigurimin B÷, do të kemi shtylla të tensionit 400kV, ku në njërin qark do të ketë izolator dhe përcjellës për tension 400kV dhe në qarkun tjetër do të ketë izolator dhe përcjellës për tension 220kV.

Pavarësisht zgjedhjes së konfigurimit A apo B, linja Tirana 2 -Rrashbull, të dyja qarqet, do të operojnë vetëm me tension 220kV edhe për një kohë të gjatë sipas anëtarëve të Këshillit Teknik.

Këshilli Teknik në mbledhjen e datës 12.11.2018 nuk ka marrë vendim për asnjë nga opsionet e propozuara, pasi votat e anëtarë pjesëmarrës në mbledhje janë ndarë janë ndarë në mënyrë të barabartë për secilin konfigurim. Në këto kushte është rënë dakord nga anëtarët e këshillit teknik, që ti paraqesin opinionet e tyre administratorit dhe në varësi të situatës financiare të kompanisë, të vendoset për variantin që do të implementohet.

Në mbledhjen e këshillit teknik të datës 23.11.2018, janë paraqitur përsëri për rivlerësim të dyja konfigurimet për projektin Linja 220kV me dy qarqe Tirana 2-Rrashbull dhe unaza 110kV e Tiranës. Në përfundim Këshilli Teknik është shprehur: *“Linja me dy qarqe Tirana 2-Rrashbull të ndërtohet sipas variantit të dytë (konfigurimi B), pra njeri qark për tension 220kV dhe qarku tjetër për tension 400kV”.*

Disa prej anëtarëve të këshillit teknik, nuk kanë qenë dakord me implementimin e konfigurimit B, pasi sipas tyre, ky opsion ***do të rriste kostot e financimit me 141,726.36 Euro*** mbi vlerën e huas.

Zv/Kryetari këshillit teknik është shprehur se: *“... i përmbahej variantit të parë (konfigurimit A) pasi: vërtetë tendenca në perspektivë është për zhvillimin e rrjetit 400kV, por edhe varianti i parë (konfigurimi A) nuk e përjashton këtë mundësi, nëse perspektiva e zhvillimit e kërkon në të ardhmen. Rrjeti 220kV tek ne është shumë i zhvilluar dhe do të mbetet ende në operim për një kohë të gjatë” (Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 10-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me këshillin teknik dhe konsulentin, të dakordësojnë termat referencës për kontraktorët e zbatimit të projektit, mbi bazën e studimit të fizibilitetit, dhe nëse ky i fundit ka nevojë për ndryshime ato të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të pasqyrohen në amendimin e marrëveshjes para se të përfshihen në dokumentet e tenderit për kontraktorët e zbatimit të projektit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, ka pasur ndryshime të vazhdueshme të personelit të njësisë së zbatimit të projektit dhe mungesë të specialistëve në fushën e inxhinierisë në stafin e PIU, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen dhe implementimin e projekteve me financime të huaja.

Sipas përcaktimeve të seksionit 2 të marrëveshjes së veçantë (zbatimi i projektit), struktura përgjegjëse për zbatimin e projektit në OST është njësia e përhershme e zbatimit të projektit (PIU), në varësi të Drejtorisë së projekteve të huaja, e cila përbëhet nga:

- Shefi i sektorit të njësisë së zbatimit të projektit (PIU);
- 2(dy) jurist;
- 2(dy) ekonomist;
- 1(një) sekretar/arkivist.

Në rregulloren e OST në lidhje me detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në aparatën qendror të OST sha është përcaktuar:

Drejtoria e projekteve të huaja garanton implementimin optimal të projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatoreve të huaj. Ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementim e projektit të huaj që në fazat e para të financimit, e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.

Spektori i projekteve PIU, ndjek projektet me financim të huaj që nga procedurat e marrëveshjes së kredisë, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesin e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit apo konsulencës, menaxhimin implementimin e projektit deri në finalizimin dhe dorëzimin e tij, dhe marrjen në shfrytëzim nga strukturat përkatëse (Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 10-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për të plotësuar strukturën e njësive të zbatimit të projekteve me specialistë inxhinier të fushës së zbatimit për projektin "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike".

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuar në marrëveshjen e huadhënësit, u konstatua se:

Nuk janë realizuar objektivat e parashikuara në marrëveshjen e huas për arritjen e rezultateve të pritshme në drejtim të rritjes së fuqisë së transmetimit të energjisë elektrike, sigurisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike. Bazuar në treguesit e performancës për vlerësimin sasior të këtij objekti, parashikohet që kapaciteti i transmetimit në rrjetin midis Tiranë - Rrashbull dhe Fier të rritet me të paktën 155M në vitin e dytë të funksionimit të dy komponentëve. Ky objektiv nuk është arritur pasi, projekti nuk është implementuar. Në marrëveshjen e veçantë të Huas së datës 02.07.2015, në aneksin 2 të saj, është përcaktuar skeduli kohor i realizimit të projektit: ***"Projekti ishte parashikuar të zbatohet gjatë viteve 2015 – 2018.***

Faza e zbatimit për Komponentin I vlerësohet të zgjasë 3 vjet, deri në fund të vitit 2017. Faza e zbatimit për Komponentin II vlerësohet të zgjasë katër vjet deri në fund të vitit 2018. Ky objektiv nuk është realizuar dhe shtyrja në kohë e tij, është shoqëruar me kosto shtesë në shumën 956,377 Euro mbi vlerën e huas. Afati i ri për realizimin e këtij projekti sipas dy komponentëve nuk është pasqyruar në amendimet e marrëveshjes së veçantë (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 19-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, të analizojë ecurinë dhe problematikat e shfaqura gjatë implementimit të projektit "Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike", si dhe të autorizojë administratorin e shoqërisë për nënshkrimin e amendimit të marrëveshjes së veçantë, ku të përcaktohet afati i përfundimit të projektit sipas të dy komponentëve të tij.

Brenda muajit janar 2022

6. Gjetje nga auditimi: Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST nr. 388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Banka Kf , me letrën e datës 26.08.2019, ka pranuar në parim shtyrjen e afatit të disbursimit, por thekson pagesën e një vlerë kompensimi si pasojë e shtyrjes së afatit të disbursimit, ku Huadhënësi pranon se kjo vlerë është bazuar në kushtet e tregut të kapitalit që ka preluar në kushtet e llogaritjes së kësaj vlere, duke theksuar se asnjë kosto shtesë nuk përfshihet në vlerën prej 861,206 Euro. Kf në kuadër të bashkëpunimit afatgjatë me OST pranon të mbulojë 50% të shumës dhe pjesa tjetër të mbulohet nga OST, dhe për këtë nuk ka asnjë llogaritje ose mënyra e llogaritjes nga banka Kf për caktimin e vlerës prej 377,519 Euro. Huamarrësi (OST) ka rënë dakord për të paguar detyrimin e paraqitur nga banka Kf dhe ka likuiduar vlerën 377,779 Euro (377,519 Euro + 260 Euro komision banke), duke rritur kostot e OST. Për këtë vlerë nuk është paraqitur nga Kf asnjë dokument për mënyrën e llogaritjes si edhe nga Drejtoria Ekonomike e OST nuk disponohet dokumentacion mbi përcaktimin e vlerës. Referuar Marrëveshjes së nënshkruar nga palët me amendimet përkatëse plani i disbursimeve është shtyrë deri në korrik të vitit 2022, ose me 3 vjet nga afati i parashikuar si pasojë e vonesave të ardhura nga procedurat e tenderimit. Vlera e detyrimit në favor të Kf është kontabilizuar në llogarinë 233 "Investime të projektit", veprimet në kontabilitet janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 17.02.2003 "Për evidentimin regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj" (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 21-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e menaxhimit të projekteve, në të ardhmen të marrë masat e duhura që ecuria e disbursimeve për projektet e financuara nga Kf apo donatorë të tjerë të huaj, të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë që mbart zgjatja në kohë e afatit të disbursimit, si dhe shmangien e procedurave të tej zgjatura që nevojiten për miratimin e ndryshimeve financiare në marrëveshjet e ratifikuara.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Shuma e disbursuar deri në datën 23.12.2021 është 7,561,247 Euro, ose 19% e shumës së kredisë, ku shumën e pa disbursuar është në nivelin e 32,438,752 Euro, në një kohë që është konsumuar koha e efektshmërisë së përdorimit të Huas sipas Marrëveshjes. Pagesat e kryera nga OST për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2021, janë në shumën 541,171.06 Euro, nga 430,945 Euro që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar **110,227 Euro më tepër** nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin, pra zgjatja e afatit të disbursimeve shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit.

-Disbursimet kanë ecur me ritme tejet të ulëta dhe vonesa të theksuara nga ku për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.

-Projekti ishte parashikuar të përfundonte në dhjetor të vitit 2018, por ende nuk ka filluar faza e implementimit, pra projekti është me 3 vite vonesë deri më datë 23.12.2021.

Amendimi i Marrëveshjes është kërkuar me shkresën e OST nr. 388, datë 11.06.2019 për vonesat e theksuara në implementimin e projektit, për rishikimin e termave të Huas dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve deri në Korrik të vitit 2022. Në datën 29.06.2018 është nënshkruar amendimi i parë i Marrëveshjes së Huas referuar skedulit të ripagesave, duke lënë të pandryshuar termat e tjerë të saj.

-Miratimi për shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2022, nuk do të jetë i mjaftueshëm, nisur nga ecuria dhe problematikat në faza të ndryshme të projektit ku ende nuk kanë filluar punimet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 21-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: OST dhe NJZP të marrin masa në të ardhmen, për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare, me qëllim minimizimin e kostove shtesë.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit për shërbimin e konsulencës, konstatohet se, në procesverbalin nr. 4944prot., datë 26.08.2015, ora 16:20, i mbajtur nga Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit, është deklaruar hapja gabimisht nga ana e punonjësës së protokollit, e kutisë dhe e zarfit të ofertës ekonomike për ofertuesin M... D...-C...

Por, me e-mail datë 26 Gusht 2015 ora 14:05 nga Njësia e Zbatimit të Projekteve (PIU) të OST është njoftuar agjenti i tenderit për mbërritjen e ofertave të aplikantëve F..., C...M... D... dhe G... I... Në këtë mënyrë, kjo njësi duhej të kishte marrë masat për ruajtjen tyre në gjendje të vulosur deri në momentin e hapjes në datën 28 Gusht 2015.

Hapja e ofertës sa më sipër, është kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në pikën 2.3, paragrafi 2.12 òUdhëzuesi për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnereò.

Me shkresën nr. 5056 prot., datë 01.09.2015, të ish Administratorit të OST është njoftuar përfaqësuesi i Kf (Banka për Evropën Juglindore dhe Turqinë) mbi ngjarjen e ndodhur sa më sipër, si edhe është kërkuar njëkohësisht anulimi i procedurës së tenderit për shërbimin e konsulentit. Në aneksin 2, bashkëlidhur òUdhëzuesit për Caktimin e Konsulentëve në Kooperimin Financiar me vendet Partnereò, pika 2, paragrafi ò...përpara një anulimi të mundshëm të tenderit” është parashikuar se: propozimi nga klienti që tenderi të anulohet

duhet të jetë me arsyetim. Kjo duhet të ndjekë kriteret e këtij Udhëzuesi dhe duhet të shoqërohet me dokumentet përkatëse si kërkohet nga Kf .

Por, kërkesa për anulimin e tenderit nuk ka ardhur për shkak të asnjë nga rastet e parashikuara në paragrafin 2.6 në Udhëzimin për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere të cilat janë:

- a) Nuk ka patur konkurrencë të mjaftueshme;
- b) Asnjë nga ofertat nuk ka arritur minimumin e pikëve;
- c) Kanë ndryshuar aspekte teknike dhe financiare bazë përpara lidhjes së kontratës;
- d) Kuotimet e çmimit janë mjaft të dukshme të larta. Në këtë rast alternativa është ose mbajtja e një procedure tenderi të ri, ose nisje e negociatave mbi çmimin me ofertuesin i cili vjen i pari;

Sa sipër, ka dështuar procesi i vlerësimit të ofertave, për shkak të mangësive në menaxhimin e procedurave të tenderit (*Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 27-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës duhet të marrin masat e nevojshme për të implementuar një sistem eficient të menaxhimit të projekteve të huaja, duke përfshirë të gjitha proceset e zhvillimit të projektit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të vlerësimit të ofertave të kontraktorëve për Lot-1, **konstatohet se**, me procesverbalin e mbajtur nga KVO nr. 53/8 prot., datë 06.04.2017, kanë kaluar fazën e parë të para-kualifikimit si më poshtë:

- K... P... P...E...T... E... Inc. është kualifikuar pa kushte;

-A.... S.p.A, E... E... e ..., C... G.. G... GmbH M... S.A me kushtin, që mangësitë respektive të konstatuara do të rregullohen në fazën vijuese të tenderit.

Në raportin paraprak të vlerësimit të ofertave teknike, të prezantuar nga Konsulenti dhe miratuar nga OST në Mars 2018, është ngritur pretendimi i verifikimit të saktësisë në kriteret para-kualifikuese për K... P... P...E... T... E... Inc si më poshtë:

-është konstatuar se në dokumentacionin e dorëzuar prej tij ka mospërputhje të dhënash (datat) për përfundimin e projektit òNdërtimi i N/St Zerjanevicò (viti 2007 apo viti 2005) dhe për këtë arsye është kërkuar plotësim dokumentacioni.

Për këtë arsye, pas sqarimeve, është kërkuar skualifikimi i këtij aplikanti.

Me e-mail datë 11. Maj 2018 nga Kf jepet dakordësia (No-Objection) e Raportit të Vlerësimit Final me shënimin ò...se ne nuk do të ndajmë plotësisht opinionin e punëdhënësit dhe konsulentit lidhur me mospërmbushjen e ofertës së prezantuar nga K... P... P... E...T... E... Inc në lidhje me kriterin e para-kualifikimit”.

Seksioni 2.7 i “Udhëzimit për Prokurimet e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve në Kooperimin Financiar me Vendet Partnere”-Gusht 2016, nuk është përjashtues në thelbin e tij, por lejon krahasimin e të gjithë ofertuesve për të përcaktuar avantazhet më të dobishme.

Pra, sa sipër në rastin e aplikantit K... nuk qëndron argumentimi se ekziston dyshimi për përmbushjen e kushteve minimale të parashikuara në fazën para-kualifikuese, pasi ky aplikant ka kaluar fazën e para-kualifikimit në mënyrë të pakushtëzuar.

Pra, në këtë fazë të procesit të përzgjedhjes të kontraktorit janë vërejtur mangësi në ushtrim të detyrave funksionale nga ana e OST për koordinimin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 27-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës duhet të marrin masat e nevojshme për të implementuar një sistem eficient të menaxhimit të projekteve të huaja, duke përfshirë të gjitha proceset e zhvillimit të projektit, me qëllim

arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Administratori i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) të marrë masa që të evidentojë detyrimet në kontabilitet dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e penaltetit në vlerën **38,973 Euro**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, nga konsulenti öF... GmbH & Co.K...ö, me anë të e faturave D17/1327 dhe D17/1328, datë 24.04.2017, është kërkuar pagesa prej **371,169.00 €**, ose 60 % e fondit të fazës A, si edhe pagesa prej **27,041.25 €**, ose 75 % e shtesës së kontratës nga amendamenti nr. 01 i kontratës nr. 1585/1prot., datë 24.03.2017.

Nga auditimi konstatohet se, nga konsulenti Raporti mbi mjedisin (ESIA Report) është dorëzuar në OST me nr. 1210prot., datë 03.03.2017, ose me vonesë prej 11 javësh, ndërsa Raporti i Detajuar i Projektimit dhe Planifikimit (Detailed Planning and Design Report) është dorëzuar me nr. 2301prot., datë 26.04.2017, ose me vonesë prej 19 javësh. Dorëzimet e raporteve nga konsulenti nuk kanë respektuar kërkesat e pikës Ad 3.4 të öKushtet specialeö të kontratës, ku janë përcaktuar afatet kur konsulenti duhet të raportojë mbi progresin e shërbimeve që ka kryer, si më poshtë:

-Raporti i Fillestar 8 javë pas hyrjes në fuqi të kontratës, ose më datë 11.11.2016;

-Raporti mbi ambientin ESIA 8 javë pas hyrjes në fuqi të kontratës, ose më datë 11.11.2016;

-Raporti i Planifikimit dhe Projektimit të Detajuar 12 javë pas hyrjes në fuqi, ose më 09.12.2016.

Për këtë arsye: Referuar paragrafit 4.2 öPenalite për Vonesënö, në kontratën e konsulentit, si edhe periudhës së vonesës nga data 11.11.2016 - 26.04.2017, ose 21 javë, llogaritja e penaltetit në **ngarkim të F... GmbH & Co.K...** është **38,973 €** ose **4,745,742.21 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 36-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Projekteve të Huaja, të marrin masa për arkëtimin e vlerës **38,973 euro** nga konsulenti F...GmbH & Co.K..., si penaltet për vonesat e shkaktuara në prezantimin e Raportit të Mjedisit *ESIA* dhe Raportit të Projektimit dhe Planifikimit të Detajuar (Detailed Planning and Design Report).

Deri më 31.03.2022

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT